

1 E enjte, 28 nëntor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
12 procesverbal që të akuzuarit janë të gjithë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit.

14 Do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë
15 W03873.

16 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
19 procesverbal se Avokati Kujdestar i Dëshmitarit W03873 është i
20 pranishëm në sallën e gjyqit.

21 Mirëmëngjes, Dëshmitar.

22 Mirëmëngjes, Avokat.

23 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
25 vazhdojmë sot me dëshminë tuaj. Ju rikujtoj të përgjigjeni

1 qartë me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje,
2 lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet ose nëse është nevoja
3 të sqarohet, lirisht kërkoni që pyetja të sqarohet.
4 Gjithashtu, mos harroni të na e thoni ku i bazoni ju njohurinë
5 tuaj lidhur me faktet dhe me rrethanat që do t'ju bëjnë
6 pyetje.

7 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
8 vërtetën sikurse vetë e thatë përmes deklaratës solemne ditën
9 e hënë.

10 Gjithashtu, garancitë që ju ka ofruar Trupi Gjykses janë
11 ende të vlefshme dhe nëse refuzoni të përgjigjeni mund të
12 gjobiteni.

13 Flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej pesë
14 sekondash përpara se të përgjigjeni dhe flisni ngadalë për
15 përkthyesit.

16 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na thoni dhe do
17 bëjmë organizimin përkatës.

18 DËSHMITARI: HALIL QADRAKU [Vijon]

19 Z. Pace, thatë që mund të kishit disa pyetje të tjera
20 plotësuese?

21 Një çast, ju lutem, Avokat.

22 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, po, z.
24 Avokat.

25 Z. KOÇI: Gjykatë e nderuar, mirëmëngjes. Gjykatës,

1 mirëmëngjes, të gjithëve. Unë e kam përshtypjen se dje nuk jam
2 lejuar ta kryej detyrën time si duhet gjatë marrjes në pyetje
3 të klientit tim. Kur Gjyqtari Mettraux ishte duke e marrë në
4 pyetje e kam ngrit disa herë dorën, jam injorur thjesht. Nuk
5 keni marrë vendim me ma ndalu pyetjen.

6 Unë, qëllimi im ka qenë që ta parandaloj që publikisht në
7 kamera të flitet për dënimin e tij për armëmbajtje pa leje,
8 dënim i cili sipas ligjit është i rehabilitu dhe së paku nuk
9 duhet të flitet në publik për këtë çështje. Kërkoj, prandaj
10 këtë vërejtje e bëna, nuk kam prit që kjo del tash dhe në
11 publikisht edhe në kamera, kërkoj që të hiqet kjo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
13 Faleminderit.

14 Z. KOCI: E kam edhe një çështje tjetër.

15 Kërkoj që klienti im --

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka lidhje me
17 qëllimin tuaj kjo për vetinkriminimin, a lidhet me
18 vetinkriminimin?

19 Z. KOCI: Ka të bëjë me trajtimin e dinjitetshëm të
20 klientit tim, që besoj dhe ajo është njëna prej detyrave të
21 mia këtu me ruajt dinjitetin e klientit tim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 Z. KOCI: Po. Gjatë marrjes në pyetje nga ana e Gjyqtarit
24 Mettraux - po tentoj me perifrazu jo me citu se nuk jam tash
25 në gjendje meqenëse nuk e kam - është hap tema e dënimit të

1 Sali Veselit. Gjyqtari, po perifrazoj, ka thënë Sali Veseli
2 është dënu, klienti im ka thënë ai është dënu po më vonë është
3 liru. Gjyqtari me një pyetje me nënkuptim të përgjigjes ka
4 thënë, "Po dhe pastaj prapë është dënu".

5 Prej këtij pozicioni të autoritetit të Gjyqtarit dhe me
6 pozicion të cilin është klienti im, ky ka thënë "Nuk e di".
7 Edhe pse në fillim ka thënë që është liru. Unë kam dash me e
8 vërtetu këtë çështje. Nuk kam reagu menjëherë. Sot e kam
9 vërtetu përfundimisht Sali Veseli ishte i liruar. Dje e pash
10 në burime publike.

11 Prandaj kërkoj që me një dinjitet edhe me një ndjeshmëri,
12 për shkak të pozicionit që e ka klienti im që të trajtohet në
13 atë formë. Kërkoj falje për këtë ndërhyrje time, por besoj që
14 kjo ka qenë detyra ime.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Pyetja që u bë dje ishte, "A është dënuar?", përgjigja
17 është që "Po, është dënuar". Fakti që u lirua më vonë nuk e
18 ndryshon faktin që zotëria në fjalë, në fakt, ishte dënuar një
19 herë.

20 Vazhdojmë.

21 Z. Dixon, besoj se ju do të filloni me pyetjet plotësuese
22 që burojnë nga pyetjet e Gjykatësve.

23 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon:

24 Z. DIXON: [Përkthim]

25 PY. Z. Qadraku, mirëmengjesi. Kam disa pyetje sqaruese për

1 ju. Ju lutem përpiguni të përgjigjeni sa më shkurt në mënyrë
2 që ta përfundojmë sa më shpjet dëshminë tuaj. E kuptoni këtë?
3 PË. Po, e kuptoj.

4 PY. Pikësëpari, Gjykatësi Barthe ju bëri një pyetje dje - e
5 cila është pasqyruar në faqen 32, rreshti 11 i transkriptit të
6 ditës së djeshme - ai ju pyeti ju dhe përmendni një dokument
7 që mbante datën 14 mars 1999, që është prova P500 tashmë. Dhe
8 ju u përgjigjët si në vijim. Unë po e lexoj:

9 "Gjatë luftës, kam qenë në Shtabin e Përgjithshëm në tri
10 raste. Gjithmonë jam përpjekur që kontaktet t'i mbaj përmes
11 komandës sime. Nuk më kujtohet ta kem kontaktuar ndonjëherë
12 Shtabin e Përgjithshëm pa njoftuar komandantin, me përjashtim
13 të rastit të atij dokumentit që lexuam dje."

14 A ju kujtohet kjo që e thatë dje?

15 PË. Po, z. Avokat.

16 PY. Që të jemi të qartë tani, lidhur me këtë dokumentin e 14
17 marsit 1999 i cili u përmend dje, a është e vërtetë se ju
18 vërtetë thatë në dëshminë tuaj se ky dokument, më duket unë e
19 kuptova që t'i the "këtë dokument ia kam dhënë komandant
20 Drinit ose Sadik Halitjahës që ishte zëvendësi i tij. Dhe
21 thatë që përmes komandës ia dërgova atyre që duhet ta merrnin
22 këtë dokument".

23 Z. DIXON: [Përkthim] Për procesverbal kjo është e thënë
24 në faqen 22723, rreshti 17 i transkriptit.

25 PY. Dëshmitar, a është kështu e thatë këtë?

1 PË. Po, z. Avokat.

2 PY. Pra, në dëshminë tuaj ju po thoni që mesa ju kujtohet ju
3 dokumenti është dërguar përmes komandës së zonës, ama ju nuk e
4 dini nëse shkoi apo jo në destinacion?

5 PË. Po, zotëri, kështu është.

6 PY. Faleminderit. Gjithashtu kam nevojë të sqarojë një pyetje
7 tjetër të Gjykatësi Barthe. Ai ju pyeti ju nëse komandant
8 Drini dhe Tahir Sinani pas tij, pra, nëse ishte detyrë e
9 komandantëve të informonin dhe të raportonin pranë Shtabit të
10 Përgjithshëm. Kjo është thënë në faqen 33, rreshti 22 e në
11 vijim të transkriptit.

12 Ju thatë:

13 "Po. Nëse ai", pra, komandanti, "e gjykonte të nevojshme
14 të raportonte propozimet e mia dhe informacionet e mia pranë
15 Shtabit të Përgjithshëm, detyra ishte e komandantit që ta
16 informonte Shtabin e Përgjithshëm."

17 A ju kujtohet kjo?

18 PË. Po, zotëri.

19 PY. Më pas, Gjykatësi ju pyeti a keni dëgjuar ju lidhur me
20 ndonjë ankesë nga Shtabi i Përgjithshëm që nuk kanë marrë
21 informacione të rëndësishme nga zona. Ju i jeni përgjigjur dje
22 dhe thatë:

23 "Nuk kam marrë asnjë ankesë as nga komandant Drini, as
24 nga Tahir Sinani, as nuk kam marrë ndonjë informatë që të ketë
25 pasur ankesë nga Shtabi i Përgjithshëm për raportimin tim apo

1 për mungesën e raportimit lidhur me pozicionet dhe lëvizjet e
2 forcave armike.”

3 A ju kujtohet kjo?

4 PË. Po, zotëri.

5 PY. Tani unë kam nevojë për një pyetje sqaruese: A është e
6 vërtetë që ju nuk e dini se çfarë informacioni përcillnin
7 komandantët tuaj në nivel të komandës së zonës, ju nuk e dinit
8 nëse komandant Drini apo komandant Sinani i përcillnin
9 informacionet në Shtabin e Përgjithshëm?

10 PË. Është e vërtetë që unë nuk e dija se çfarë ata kanë
11 raportuar dhe çfarë i kanë dhënë nga ato raporte Shtabit të
12 Përgjithshëm.

13 PY. Pra, ju nuk e dini çfarë informacionesh ka marrë Shtabi i
14 Përgjithshëm dhe çfarë bënë ata me këto informacione nëse
15 merrnin ndonjë informacion të tillë, saktë?

16 PË. E saktë, zotëri.

17 PY. Tani kam një pyetje tjetër që po ashtu lidhet me pyetjet
18 e Gjykatësi Barthe, është në faqen 51, rreshti 22 e në vijim.
19 Gjykatësi ju pyeti “nëse ishte e rëndësishme për ju
20 personalisht që të jepnit informacion Shtabit të Përgjithshëm
21 lidhur me ato që kishit parë dhe kishit vrojtuar. A ishte kjo
22 e rëndësishme për ju si person?”

23 Ju u përgjigjët:

24 “Padyshim që po. Por unë kam menduar që ka ekzistuar një
25 strukturë. Shtabi i Përgjithshëm ka pasur një strukturë të

1 mirorganizuar që i merrte të gjitha raportet që dërgonim ne
2 nga baza dhe kishin një sistem dhe ata i analizonin dhe kishin
3 një panoramë të qartë të lëvizjeve përfshirë lëvizjet e
4 armikut.”

5 Ju kujtohet përgjigja që i dhatë dje, Gjykatësit?

6 PË. Po, zotëri, më kujtohet. Dhe kam menduar gjithmonë se
7 raportet e mia ishin të domosdoshme për të informuar Shtabin e
8 Përgjithshëm. Është e vërtetë se kam menduar se ata kanë një
9 sektor të madh të analizave për të analizuar lëvizjet e
10 forcave në të gjithë Kosovën. Unë ashtu kam menduar. Ishte
11 opinionimi im dhe ishte mendimi im ky.

12 PY. Faleminderit, z. Qadraku. Po unë e kuptoj këtë. Por ama
13 është e vërtetë që ju në realitet nuk e keni ditur se çfarë
14 informacionesh merrte Shtabi i Përgjithshëm dhe se çfarë bënte
15 me informacionet që merrte?

16 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Sepse është bërë pyetja
17 dhe është marrë përgjigje.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
19 kundërshtimi.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull.

21 PY. A është e vërtetë, z. Qadraku, se ju nuk e dini se si
22 funksiononte vetë Shtabi i Përgjithshëm? Pra, ju nuk e dini se
23 si funksiononte brenda për brenda Shtabi i Përgjithshëm,
24 saktë?

25 PË. Është e vërtetë, zotëri. Nuk e dija.

1 PY. Dhe ju e thatë dhe më herët, por ju nuk keni marrë asnjë
2 raport prej tyre, apo jo - as nga Shtabi i Përgjithshëm as
3 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm - ju s'keni marrë ndonjë
4 raport përmes komandantit të zonës që të buronte nga Shtabi i
5 Përgjithshëm, kështu?

6 PË. Po, z. Avokat. Kurrë për atë kohëzgjatje pesë muaj e
7 katër-pesë ditë sa kam qenë shef i G2 në Zonën Operative të
8 Pashtrikut gjatë luftës, unë kurrë nuk kam marrë ndonjë
9 raport, ndonjë urdhër, ndonjë kërkesë, ndonjë njoftim nga
10 Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

11 PY. Gjithashtu ju nuk e dini nëse takohej rregullisht Shtabi
12 i Përgjithshëm apo nëse takohej fare, ju s'keni asnjë dijeni
13 lidhur me këtë, apo jo?

14 PË. Jo, zotëri, nuk kam, as nuk kisha.

15 PY. Në një pyetje tjetër Gjykatësi Barthe ju pyeti lidhur me
16 një intervistë që i keni dhënë ZPS-së ku kishit thënë që:

17 "Kadri Veseli dhe Shtabi i Përgjithshëm kishte të njëjtat
18 përgjegjësi, detyrë për të informuar Azem Sylën njësoj si unë
19 ..."

20 Dhe më pas vijoni dhe thoni që kjo vlen dhe për gjithë
21 Kosovën. A ju kujtohet kjo përgjigje?

22 PË. Po, zotëri, më kujtohet.

23 PY. Dhe më pas Gjykatësi ju bëri një propozim dhe ju tha:

24 "Po a pajtoheni ju që në bazë të deklaratës suaj ka qenë
25 edhe më e rëndësishme që Shtabi i Përgjithshëm të ishte i

1 informuar çfarë po ndodhte në shtatë zonat operative?"

2 Dhe ju u përgjigjët:

3 "Kështu mendonim ne. Kështu mendonim ne se duhet të
4 ishte."

5 Ju kujtohet kjo?

6 PË. Po, zotëri, më kujtohet.

7 PY. Por në fakt ama, zotëri, ju nuk keni asnjë informacion të
8 drejtpërdrejtë se cilat ishin përgjegjësitë e z. Kadri Veseli
9 apo të anëtarëve të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm? A është
10 kështu?

11 PË. Po, zotëri. Edhe këtë e kam thënë.

12 PY. Faleminderit. Tani kam disa pyetje që lidhen me pyetjet
13 që ju bëri Gjykatësi Mettraux. Kjo ka lidhje me dokumentin --
14 më fal, me dokumentin e datës 18, 19 gusht 1999. A ju kujtohen
15 pyetjet që ju bëri Gjykatësi Mettraux lidhur me këto dy
16 dokumente që jua shfaqti përbri dje në ekran?

17 PË. Po, zotëri, më kujtohet.

18 PY. Gjykatësi ju bëri pyetje për faktin që dokumentet ishin
19 gjetur në banesën tuaj në Prizren në maj të 2001, kështu, ju
20 kujtohet?

21 PË. Po, zotëri. Kështu ishte.

22 PY. Tani do t'ju bëj disa pyetje sqaruese sesi përfunduar
23 këto dokumente në shtëpinë tuaj në Prizren. Supozoj se këto
24 dokumente kanë qenë në selinë e zonës në Nishor gjatë luftës,
25 apo jo?

1 PË. Këto dokumente, unë, kanë qenë në arkivin tim. Sepse
2 gjithmonë një kopje e kam ruajtur për arkivin tim. Edhe atë
3 arkiv unë gjatë luftës e kam propozuar për ta ruajtur për më
4 vonë ose për muze ose për gjykatën tonë ose për nevojat e
5 shtetit tonë, nëse do t'i duheshin. Ishin arkiva e ime gjatë
6 luftës.

7 PY. Dhe arkivën ku e mbanit ju? A e mbanit në zyrat e
8 Nishorit gjatë luftës, zyrat, selinë, ku e mbanit arkivën?

9 PË. Arkiva ime mbahej gjithmonë në zyrë, po jo të gjitha
10 dokumentet. E kishim dhe një bunker sekret, një bunker të
11 vogël ku i ruaja dokumentet më të vjetra nëse do të duhet t'i
12 qartësonim apo t'i lexonim dhe një herë apo t'i riktheheshim,
13 unë t'i kisha diku në një vend. Kështu që i kam ruajtur mirë
14 gjatë tërë luftës deri pas përfundimit të saj. Po jo çdo herë
15 kanë qenë me mua në zyrë, sepse zyrat tona kanë lëvizur dhe ne
16 kemi lëvizur, nuk kemi pas mundësi të qëndrojmë gjithmonë me
17 një vend.

18 PY. Atëherë është e vërtetë që në mënyrë që këto dokumente që
19 kanë qenë në zyrë dhe në bunker të përfundonin në shtëpinë
20 tuaj në Prizren, i takon që ju i keni marrë dalëngadalë i keni
21 marrë dalëngadalë këto dokumente dhe i keni çuar në shtëpinë
22 tuaj në Prizren ku më pas u gjetën nga UNMIK-u, kështu?

23 PË. Po, ashtu.

24 PY. Kur i keni marrë këto dokumente, ju keni marrë dokumentet
25 tuaja në zyrë, keni marrë dokumentet në bunker, keni marrë

1 vetëm dokumentet tuaja apo keni marrë edhe dokumente që u

2 përkisnin personave të tjerë? E mbani mend?

3 PË. Mesa mbaj mend unë, unë kam marrë me vete vetëm

4 dokumentet që më përkisnin mua dhe që më përkisnin arkivës

5 time.

6 PY. Po dokumentet në bunker? Më duket se thatë që ishin disa

7 dokumente në një bunker të fshehtë. A i morët dhe këto

8 dokumente dhe i çuat në shtëpinë tuaj në Prizren?

9 PË. Po, z. Avokat edhe ato i kam marrë. Dhe i kam çuar në

10 shtëpi. Disa nga ato janë treguar edhe këtu para Gjykatës që

11 datojnë për kohën e luftës.

12 PY. A është e vërtetë që gjatë kohës që po i merrnit këto

13 dokumente, i grumbullonit dhe i çoni në shtëpinë tuaj në

14 Prizren, ju nuk është se i lexonit ato rregullisht. Thjesht i

15 keni mbajtur të ishin si dokumente në rast se do të duheshin

16 më vonë?

17 PË. Po, zotëri, është e vërtetë. Ato më dhe as unë s'besoj që

18 t'i kem lexuar pas përfundimit të luftës. Por vetëm i kam

19 ruajtur aty t'i kemi si një dëshmi e punës time të vogël.

20 PY. Pra, ju nuk i keni lexuar këto dokumente pas luftës në

21 shtëpinë tuaj në Prizren?

22 Z. PACE: [Përkthim] Besoj se ky aspekt u mbulua. Kur i

23 tha "lexoj" është e njëjta gjë si "i rilexuat". Nuk e kuptoj

24 pse është nevoja të përsëritet.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet

1 kundërshtimi.

2 Avokat, mund të vazhdoni.

3 DËSHMITARI: Po. Pas luftës mendoj që unë nuk i kam lexuar
4 edhe rilexuar ato dokumentet e mia. Sepse nuk kisha dhe
5 nevojë. Po të ma kishte kërkuar ndonjë institucion përkatës,
6 ndonjë gjykatë, ndonjë muze, ndonjë -- kushdo qoftë nga
7 institucionet e larta unë do t'i kisha dorëzuar të gjitha. Dhe
8 për atë dhe i kam ruajtur se mua nuk më hynin në punë ato
9 dokumente.

10 Z. DIXON: [Përkthim]

11 PY. Shoqja juaj, Peka, që ka qenë ndihmësja më duket se thatë
12 ose administratorja në sektorin tuaj, po Peka ka pasur
13 dokumente që ua dha ju që t'i ruanit në shtëpinë tuaj në
14 Prizren?

15 PË. Në fakt, të gjitha këto dokumente të kohës së luftës
16 ishte ajo që i bunkerizonte dhe ishte ajo që i fshihte edhe i
17 ruante. Unë nuk kisha kohë të mirresha ndoshta me këto. Jam
18 marrë me punë tjera nëpër teren, nëpër operativë. Kurse unë
19 besoj se ajo ishte më meritorja për ruajtjen e atyre
20 dokumenteve që kanë arritur të mbijetojnë nga koha e luftës
21 deri në atë kohë kur unë jam arrestuar.

22 PY. A është e vërtetë që ajo ju ka ndihmuar ose për një pjesë
23 të grumbullimit të dokumenteve, pra, ju ka ndihmuar që t'i
24 merrnit bashkë dokumentet dhe t'i çonit në shtëpinë tuaj në
25 Prizren? Kështu ka ndodhur?

1 PË. Po, zotëri.

2 PY. Do t'ju lexoj një pjesë të intervistës që i keni dhënë
3 Gjykatësit hetues. Gjykatësi Mettraux trajtoi disa pjesë të
4 kësaj interviste.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk është nevoja të shfaqet në
6 ekran. Unë do ua lexoj dhe do ta merrni përkthimin nga
7 përkthyesit. Është faqja 123456. Për këtë pjesë ju bëri pyetje
8 ju Gjykatësi Mettraux.

9 PY. Gjykatësi ose gjykatësja hetuese ju ka treguar në këtë
10 momente "faqen e dytë të një aktekspertizë lidhur me shkrimin
11 e dorës të 'Deklaratës së Kimete Krasniqit' ". Dhe thotë:
12 "Dëshmitari e lexoi dokumentin".

13 Dhe ju i jeni përgjigjur:

14 "E lexova po të ketë qenë në dosjet e mia dhe mund të
15 ketë qenë, nuk e konfirmoj as nuk e mohoj. Nuk më kujtohet.
16 Nuk e mbaj mend. Unë thjesht pranoj dokumentin e mëparshëm për
17 shkak se ka nënshkrimin tim në të ..."

18 Ky është dokumenti i 19 gushtit 1999, për këtë e kemi
19 fjalën.

20 "... por ama për këtë deklaratë, kur më kanë arrestuar
21 unë kam pasur 400 kile dokumente me vete dhe nuk e di nëse ky
22 dokument ka qenë pjesë e tyre."

23 A ju kujtohet kjo përgjigje në lëndën gjyqësore në Kosovë

24 --

25 PË. Po, zotëri.

1 PY. -- që i ke thënë gjykatësit hetues?

2 PË. Po, zotëri. Më kujtohet. E kam dhënë këtë deklaratë
3 derisa isha i burgosur në vitin 2002 më duket.

4 PY. Kur thatë që nuk ju kujtohet, a është arsyeja sepse ju në
5 fakt s'i kishit shqyrtuar këto dokumente kur i keni pasur ë
6 shtëpinë tuaj, s'i kishit lexuar ndonjëherë as më përpara,
7 kështu?

8 PË. Po, zotëri.

9 PY. Thatë që keni pasur një vëllim të madh dokumentesh. A
10 bëhet fjalë për mijëra faqe?

11 PË. Po, zotëri. Bëhet fjalë për mijëra faqe që kanë qëlluar
12 aty. Mirëpo unë kam pasur edhe dokumente të tjera. Z.

13 Gjykatës, unë i kam ofruar edhe z. Prokuror një video filmik i
14 cili nuk ishte i filmuar nga unë, po ishte i filmuar nga ICTY,
15 domethënë, Gjykata e Hagës. Unë kam dorëzuar mbi 3.000
16 kilogram dokumente Gjykatës së Hagës.

17 Domethënë, gjatë punës time kam pas punë shumë të bëj me
18 dokumentacion edhe me dorëzimin e tyre me ndihmimin e
19 hetuesisë. Kështu që të gjitha këto gjërat tani mu më janë
20 përzier e disa nga ato kanë qëlluar te shtëpia ime kur unë jam
21 arrestuar në vitin 2001.

22 PY. Faleminderit, zotëri.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Do kërkoja tani që të shfaqeshin në
24 ekran dy dokumente dhe kjo është pjesa e fundit e pyetjeve që
25 kam unë. Dokumenti i parë është SPOE00035842 deri në 00036049

1 dhe duhet të shohim faqen 147 të PDF-së.

2 Të nderuar Gjykatës, ky është hetimi në lëndën gjyqësore
3 për të cilën i bëri pyetje Gjykatësi Mettraux dëshmitarit dje.
4 PY. Është një dokument që është vetëm në anglisht
5 z. Qadraku, megjithatë do t'jua lexoj, merreni përmes
6 përkthimit dhe komentoni më pas.

7 Sikurse mund ta shikoni këtu bëhet fjalë për një listë
8 provash që mban datën 15 mars 2002, në kolonë aty thuhet:

9 "Një, pra, shikoni një letër origjinale e shkruar me
10 kompjuter e UÇK-së e nënshkruar nga Halil Qadraku që i
11 bashkëlidhet një kopje të një letre që shkruhet me shkrim dore
12 nga Kimete Krasniqi."

13 A e shikon këtë përshkrimin në faqe, Dëshmitar?

14 PË. Po, zotëri, e shikoj.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që në faqen
16 tjetër ose në pjesën e dytë të ekranit të mund të shfaqë një
17 faqe tjetër të këtij dokumenti që është faqja 99. Është në
18 anglisht dhe kjo faqe, megjithatë do ta lexoj dhe ju merreni
19 përmes përkthimit.

20 PY. Këtu kemi një shënim nga hetuesit në këtë lëndë. Mund të
21 shikoni që data është 5 prill 2002, çfarë do të thotë që kjo
22 ka ndodhur pas listës së provave që pamë pak më herët,
23 domethënë, koha kur është shkruar ky dokument është prilli.
24 Atëherë do lexoj atë çfarë thuhet që nga fillimi:

25 "U takuan me Schmidt. Kërkuan të gjitha kutitë me

1 dokumente që kishte Halil Qadraku" --

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është në
3 ekran. Nuk keni faqen e duhur.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
5 Nuk ishte vërtetë në ekran.

6 PY. Kështu që do filloj dhe një herë tjetër. Jemi tek ora
7 2.00, 14:00. Atëherë teksti thotë:

8 "U takua me Schmidt nga RIU Prizren. Kontrolluam të
9 gjitha kutitë e marra nga Halil Qadraku, nuk e gjetëm dot
10 letrën origjinale të Kimete Krasniqit. Shkruesi gjeti një
11 letër origjinale që ishte nënshkruar në fund nga Halil Qadraku
12 (që ishte e ngjashme me letrën që ne kishim, por data ishte e
13 ndryshme, domethënë, data ishte 18 gusht 1999). Bashkëlidhur
14 kësaj letre ishte një kopje e letrës së Kimete Krasniqit. RIU
15 nuk e di në qoftë se ka pasur një kopje gjithmonë dhe në qoftë
16 se ka pasur një kopje dhe nuk e dinë se ku është letra
17 origjinale që ka qenë bashkëlidhur, sepse kjo nuk përmendet
18 fare në dosje. Shkruesi ka sekuestruar një letër origjinale të
19 UÇK-së dhe një kopje të letrës së Kimete Krasniqit sepse ajo
20 ishte në një formë më të mirë sesa kopja jonë. Gjithashtu ne
21 nuk e gjetëm dot letrën origjinale të UÇK-së që ishte
22 nënshkruar nga Qadraku dhe që mbante datën 19-08-1999."

23 A e ndoqët këtë, z. Qadraku? Pra, unë thjesht sapo lexova
24 për procesverbal tekstin në anglisht dhe po ju pyes tani që a
25 dëgjuat se çfarë shkruhet në këtë tekst, z. Qadraku?

1 PË. Po, z. Avokat, e dëgjova.

2 PY. Ju keni dhënë dëshmi, z. Qadraku, që një pjesë e letrës e
3 datës 19 gusht, pra, keni thënë që nuk e keni parë pjesën që
4 ishte shkruar me shkrim dore të shkruar, pra, gjithsesi keni
5 thënë që nënshkrimi në fund është nënshkrimi juaj. Pyetja që
6 kam për juve është kjo: Gjatë këtyre hetimeve, gjatë kësaj
7 lënde gjyqësore a kujtoni në qoftë se keni parë apo jo
8 versionin origjinal të këtij dokumenti? Domethënë, origjinali
9 që do ishte versioni i shkruar me atë pjesën me shkrim dore
10 nga z. Sinani në fund. A ju kujtohet a e keni parë ndonjëherë
11 versionin origjinal me shkrimin e dorës nga z. Sinani,
12 Dëshmitar?

13 PË. Jo, zotëri, nuk më kujtohet origjinali. Gjithmonë kanë
14 qenë të tilla si kopje. Si këtu që më janë pasi në të cilat --
15 edhe atëherë edhe sot ju kam thënë që nuk besoj që kanë qenë
16 aty, por i pranoj nëse ata veç këmbëngulin që e kanë gjet. Nuk
17 e kam parë origjinalin kurrë.

18 PY. Është e saktë, apo jo, që dëshmia juaj është që ju nuk e
19 dini se çfarë ka ndodhur me dokumentin e 19 gushtit, në qoftë
20 se ai është dërguar diku tjetër, apo jo, është e saktë kjo që
21 ju nuk dini se çfarë ka ndodhur me atë dokument, apo jo,
22 Dëshmitar?

23 PË. Po, zotëri. Unë nuk e dija sepse unë vetëm i kam dorëzuar
24 atë kërkesë komandant Tahir Sinanit.

25 PY. Faleminderit, z. Qadraku. Nuk kam pyetje të tjera për

1 juve.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar anëtarë të
3 Trupit Gjykses.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
5 Tani e ka radhën Mbrojtja e z. Thaçi.

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

7 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj.

8 Tavakoli:

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

10 PY. Kam disa pyetje për ju, Dëshmitar. Dje në transkriptin e
11 përkohshëm në faqen 53.22, Gjykatësi Barthe ju bëri një pyetje
12 lidhur me paragrafin 44 të shënimit përgatitor. Më konkretisht
13 juve ju pyetët lidhur me përfshirjen tuaj në një komision për
14 vlerësimin e kërkesave për statusin e veteranëve. A ju
15 kujtohet kjo pyetje, Dëshmitar?

16 PË. Po, më duket se po. Po i tregova vetë se isha aty. Nuk --
17 përafërsisht më kujtohet.

18 PY. Faleminderit. Pyetjet e mia për ju janë këto: Është e
19 saktë, apo jo, që ka pasur një marrëveshje politike ndërmjet
20 Hashim Thaçit, udhëheqësit të PDK-së dhe zëvendëskryeministrit
21 dhe Isa Mustafës dhe udhëheqësit të LDK-së dhe kryeministrit
22 që të përfshihen ish-anëtarë të FARK-ut në kategorinë e
23 njerëzve që mund të kërkonin statusin e veteranëve? Ju lutem,
24 përgjigjuni kësaj pyetjeje me "po" ose me "jo"? Është e saktë,
25 apo jo?

Dëshmitari: Halil Qadraku (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Tully

Faqe 20

1 PË. Po.

2 PY. Po ashtu është e saktë që në atë kohë PDK-ja dhe LDK-ja
3 ishin në qeverisje, në koalicion me njëra-tjetrën, a është e
4 saktë kjo?

5 PË. Po, zonjë.

6 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje tjera për ju.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. Tully.

9 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

10 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Tully:

11 Z. TULLY: [Përkthim]

12 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Kam disa pyetje për ju lidhur me
13 një dokument që ju tregoi Gjykatësi Mettraux në pyetjet që ju
14 bëri dje.

15 Z. TULLY: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që për këtë
16 të paraqesë në ekran dokumentin 074625 deri në 074633-ET.

17 Faleminderit. Dhe në këtë faqe, domethënë, ky është dokumenti.

18 Po shkoni tek faqja që përmenda pak më lart. Është në shqip,
19 por do kërkoja që të paraqitet dokumenti në anglisht. Versioni
20 në shqip ka të njëjtin në rregull ERN.

21 PY. Ndërkohë që po presim që dokumenti tjetër të paraqitet në
22 ekran, juve ju kujtohet, apo jo, Dëshmitar, që t'ju jenë bërë
23 pyetje lidhur me këtë dokument dje?

24 PË. Po, z. Avokat.

25 PY. Në rregull. Do të përqendrohemi tek të njëjtët paragrafë

1 për të cilët iu bënë pyetje fillimisht ju. Atëherë do fillojmë
2 tek paragrafi që fillon "me 1993 deri më 1995". Sikurse e tha
3 Gjykatësi Mettraux të gjitha vendet që shënohen këtu janë
4 Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, apo jo, është e saktë kjo,
5 Dëshmitar?

6 PË. Po, zotëri. Është e saktë.

7 PY. Dua të përqendrohemi tek lista e emrave që shkruhen pas
8 këtyre vendeve. Kështu që do ju kërkoja që t'i lexonit dhe një
9 herë. Ka disa emra aty që nuk mund të kenë qenë pjesë e këtyre
10 këshillave dhe, për shembull, emri juaj, Halit Qadraku, nuk
11 është në këtë listë, ju nuk keni qenë në Kosovë në atë rast në
12 atë kohë, apo jo, Dëshmitar?

13 PË. Po, z. Avokat. Unë nuk kam qenë në Kosovë. Mirëpo, kam
14 shkuar dy herë në vit në Kosovë. Pra, isha një mërgimtar në
15 Zvicër edhe dy herë në vit, çdo vit, kam kontaktuar dhe kam
16 punuar dhe kam vepruar edhe në Kosovë me aq kohë sa kam kaluar
17 në pushime atje.

18 PY. Ju nuk keni qenë pjesë e ndonjë këshilli që janë
19 përmendur këtu, domethënë, nuk keni qenë pjesë e këtyre
20 emrave, apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Këta emra figurojnë në të gjithë Kosovën. Unë kam mund të
22 veproj me Dyrkish Gashin. Ka mund të veproj me Selim Gashin,
23 sepse ishin nga komuna ime. Ishim nga Rahoveci, rrethinë.
24 Kështu që ne në atë kohë edhe nuk i kemi dit të gjithë këta
25 emra sepse ishin shumë konspirativë. Secili ka punu në komunën

1 e vet, në vendin e vet me shokë e vet, me njerëzit e vet. Unë
2 e di se me z. Selim Gashi dhe Dyrmish Gashi e di që kemi
3 bashkëvepruar edhe atëherë në vitin 1993, 1994, 1995 edhe më
4 herët me së bashku me idealin tonë që e kishim në komunën tonë
5 atëherë Ukshin Hotin, të cilin na e vrau okupatori serb në
6 vitin 1999.

7 PY. Po z. Ragip Shala a ka qenë në Kosovë në atë kohë apo ka
8 qenë në Zvicër?

9 PË. Unë kujtoj se z. Ragip Shala ka ardh në Zvicër në vitin
10 1997 duke qenë i ndjekur nga policia serbe. Atëherë kur edhe
11 babai i -- kishte ardhur bashkë me Fatmir Limën. Në atë kohë,
12 babai i Fatmir Limës dhe vëllau i Fatmir Limës u burgosën në
13 Kosovë dhe këta ishin të detyruar që të dilnin në ekzil. Pra,
14 Ragipi dhe Fatmiri, unë kujtoj, se kanë ardhur bashkë në
15 Zvicër, të ikur nga okupatori serb.

16 PY. Në rregull. Juve ju bë një pyetje konkretisht dhe për
17 procesverbal është bërë në faqen 79, Gjykatësi Mettraux ju
18 pyet:

19 "A pajtoheni me sugjerimin që bëhet këtu, deri në masën
20 që ju i njihni këta persona, sigurisht, që këta janë
21 veprimtarë të mirënjohur të cilët kanë kaluar nga puna
22 politike në punë ushtarake gjatë kësaj periudhe?

23 Dhe përgjigja që ju jepni është:

24 "Pajtohem me këtë."

25 Dhe ju thoni më konkretisht që "Unë pajtohem që ne kemi

1 qenë në shërbim", nuk e kuptoj shumë mirë këtë përgjigjen që
2 keni dhënë, Dëshmitar, kështu që dua që të ma shpjegoni pak, e
3 keni fjalën që keni qenë në shërbim, keni qenë në shërbim të
4 LDK-së, të UÇK-së, nuk e di në qoftë se mund ta shtjelloni pak
5 më tej? Ose të dyve, domethënë, të LPK-së edhe të UÇK-së, apo
6 të të dyjave, në shërbim të njërës apo tjetrës apo të të
7 dyjave?

8 PË. Unë si anëtar i thjeshtë i LPK-së, kam qenë në shërbim të
9 atëherë të organizatës, të Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe
10 kam qenë në shërbim të të gjitha grupeve që vepronin, punonin.
11 Nëse ata do më jepni mu ndonjë detyrë që t'i çoj ndonjë
12 informatë, që të çoj ndonjë ndihmë, që t'i çoj, pavarësisht se
13 çka, po isha në shërbim.

14 PY. Ju kërkoj ndjesë, Dëshmitar. Besoj se e kemi të qartë se
15 keni bërë ju, megjithatë le të shikojmë përgjigjen që keni
16 dhënë më pas. Gjykatësi vazhdon:

17 "Pra, ju nuk keni asnjë problem këtu lidhur me emrat?"

18 Ju përgjigjeni:

19 "Jo, nuk kam ndonjë problem. Sepse janë 99 për qind ose
20 100 për qind të këtyre emrave që jepen këtu, këto emra i kam
21 njohur. Nuk është se pjesa më e madhe e tyre ose kanë vdekur
22 ose janë vrarë, megjithatë i kam njohur pjesën më të madhe të
23 tyre."

24 A e kuptoj unë siç duhet që përgjigja juaj është që në
25 përgjithësi ju i njihnit emrat e personave që ishin në listë

1 apo thjesht i kishit dëgjuar si emra dhe nuk është se i
2 njihnit personalisht? Domethënë, si duhet ta kuptoj përgjigjen
3 tuaj?

4 PË. Pra, disa nga këta i kam njohur personalisht. Disa për ta
5 kam lexuar. Kurse tani, në vitin 2024, mund të them që i njoh
6 të gjithë.

7 PY. Në rregull. Gjykatësi ju ka pyetur konkretisht, në qoftë
8 se ju e dinit që këta personat kishin kaluar nga puna politike
9 në punë ushtarake gjatë kësaj periudhe. Pra, në vitin 1993
10 deri në 1995. A e kuptoj drejt përgjigjen tuaj që ju nuk keni
11 njohuri vetjake ose personale të veprimtarive politike dhe
12 ushtarake të të gjithë këtyre personave që ishin në listë në
13 periudhën 1993 deri në 1995? Edhe pse mund t'i keni njohur
14 këta persona personalisht ju.

15 PË. Po, zotëri. Ashtu është. Shumë e saktë. Unë, në atë kohë,
16 nuk kam njohur veprimtarinë e të gjithë këtyre. Sepse ishim,
17 thashë edhe më herët, ishim në mënyrë të fshehtë duke vepruar
18 brenda vendit.

19 PY. Pra, të përqendrohemi tek z. Selimi, unë e kuptoj që
20 dëshmia juaj deri tani është që ju nuk keni qenë i informuar
21 për veprimtaritë e z. Selimi gjatë periudhës kur keni jetuar
22 në Zvicër, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

23 PY. Po, z. Avokat.

24 PY. Në dokument edhe kjo në fakt vjen drejtpërdrejt nga LPK-
25 ja, pra, të gjithë personat që renditen këtu janë persona të

1 njohur në historinë e vonë të Kosovës, siç thuhet edhe në këtë
2 dokument. Si pjesë e promovimit politik dhe nga përvoja jua
3 me partitë politike, a do ishte me avantazh për LPK-në në 2002
4 që të theksoheshin të gjithë këto emra si pjesë e historisë
5 zyrtare të saj, a pajtoheni me këtë?

6 PË. Po. Mendoj se edhe kjo është bë për një qëllim
7 informativ, për një qëllim afirmativ, për të afirmuar Lëvizjen
8 Popullore të Kosovës edhe vetveten.

9 PY. Atëherë sa i takon nivelit të hollësive të përmban ky
10 dokument. Në dokument nuk renditet ndonjë këshillë, domethënë,
11 këshilla konkret dhe personat në listë nuk thuhet që janë
12 dhënë kanë thënë konkretisht të lidhur me këshilla specifik,
13 apo jo?

14 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë, të nderuar Gjykatës.
15 Sepse po pyetet një pyetje që nga e cila dëshmitari nuk është
16 se mund ta dijë përgjigjen.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
18 përgjigjuni, Dëshmitar. Rrëzohet kundërshtimi.

19 Z. TULLY: [Përkthim]

20 PY. Atëherë dokumenti nuk jep asnjë lidhje ndërmjet personave
21 që renditen këtu dhe këshillat ku prezumohet që ata kanë bërë
22 pjesë, apo jo, Dëshmitar?

23 PË. Po, z. Avokat. Këtu vetëm përmenden si emra po nuk jep
24 lidhje mes këshillave dhe mes grupeve kush me kënd ka kanë
25 vepru.

1 PY. Atëherë sa i takon nivelit të punës së tyre politike ose
2 përfshirjes së tyre me LPK-në, nuk jepet asnjë lloj përshkrimi
3 se çfarë përfshirjeje ose çfarë veprimtarie kanë pas ata me
4 LPK-në, a është e saktë kjo, Dëshmitar? Ju lutem përgjigjuni
5 me po ose jo?

6 PË. Po, zotëri.

7 PY. Në rregull. A pajtoheni me mua se termi ose fjala
8 "veprimtar" që përdoret këtu është shumë i përgjithshëm. Dhe
9 nuk është se lidhet me ndonjë nivel eprori ose me ndonjë
10 autoritet të caktuar që dikush mund të ketë pasur brenda LPK-
11 së. Pra, është thjesht një term i përgjithshëm nuk është se
12 jep ndonjë hollësi dhe nuk është se tregon që dikush mund të
13 ketë qenë kryetar i një këshilli, a është e saktë kjo,
14 Dëshmitar?

15 PË. Po, zotëri. E saktë është.

16 PY. Në fund dua që të shikojmë paragrafin e fundit. Është
17 paragrafi që fillon me datën 17 nëntor 1994, thuhet që:

18 "U lëshua komunikata e parë ushtarake. Kryesia e LPK-së
19 pas insistimit të grupeve të armatosura brenda vendit merr
20 vendim për fillimin e lëshimeve të komunikatave në të cilat
21 merret përsipër autorësia e tyre."

22 As në këtë dokument nuk thuhet ose nuk specifikohet se
23 cilat janë grupet e armatosura që e kanë bërë këtë gjë, a
24 është e saktë kjo, po ose jo, Dëshmitar?

25 PË. Po, zotëri, e saktë është.

1 PY. Së fundi, në të nuk thuhet që ndonjë nga personat që
2 jepen më sipër, në paragrafin më sipër kanë qenë pjesë e
3 këtyre grupeve që kanë bërë lëshimin e komunikatave, a është e
4 saktë kjo, Dëshmitar?

5 PË. Po, ashtu shkruan.

6 PY. Ju falënderoj.

7 Z. TULLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam pyetje
8 tjera.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] U ngrita në këmbë sepse nuk
10 janë pasqyruar tetë fjalë nga pyetja që bëra unë, domethënë,
11 nuk janë pasqyruar në transkript. Nuk e di për procesverbal më
12 lejoni që ta përsërisë edhe një herë pyetjen apo ta
13 korrigjojme?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
15 përsëriteni.

16 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj.

17 Tavakoli: [Vijon]

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

19 PY. Do ta përsëris edhe një herë pyetjen që bëra dhe ju lutem
20 përsërisni përgjigjen që dhatë se nuk është pasqyruar në
21 transkript. Pyetje: A është e saktë, apo jo, që ekziston një
22 marrëveshje politike midis Hashim Thaçit drejtuesit të PDK-së
23 dhe zëvendëskryeministrit dhe Isa Mustafës, udhëheqësit të
24 LDK-së dhe kryeministrit për të përfshirë ish-anëtarë të FARK-
25 ut në kategorinë e personave të cilët mund të kërkonin

1 statusin e veteranëve, mund të bënin kërkesë për statusin e
2 veteranëve?

3 PË. Po, zonjë. Është e vërtetë.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. Ellis, fjala për ju.

7 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

8 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis:

9 Z. ELLIS: [Përkthim]

10 PY. Mirëmengjes. Unë jam Aidan Ellis dhe jam përfaqësuesi i
11 Jakup Krasniqit. Dua të cekë një temë me ju, Dëshmitar. Kjo
12 temë rrjedhë nga pyetjet që ju bëri Gjykatësi Mettraux në
13 transkriptin e përkohshëm kjo pasqyrohet në faqen 83 dhe ka të
14 bëjë me rastin e vrasjes së komandant Drinit.

15 Do ju lexoj pyetjet dhe përgjigjet e dhëna prej jush. Për
16 procesverbal kjo jepet në faqen 22860, në rreshtin 22. Ju u
17 pyetët si më poshtë:

18 "Dhe të bashkakuzuarit e tjerë dhe anëtari tjetër i UÇK-
19 së Sali Veseli ka qenë dënuar, nëse e kuptoj unë, për një
20 komplot për të vrarë Drinin, a është e saktë kjo?"

21 Dhe ju thoni:

22 "Për momentin unë jam deklaruar i pafajshëm, ndërkohë që
23 ai dënua me 15 vite, por unë e di që pas një viti ai u
24 deklarua i pafajshëm dhe u lirua për pasojë.

25 "PY. Por atëherë ai u rigjykua dhe u dënua përsëri, a ka

1 ndodhur kështu?

2 Përgjigja juaj është:

3 "Nuk më kujtohet, të nderuar Gjykatës. Mund të ketë pasur
4 ndonjë gabim. Ajo çfarë mbaj mend unë është që ai është
5 deklaruar i pafajshëm dhe një herë është liruar. Nuk më
6 kujtohet pjesa tjetër."

7 A ju kujtohet të keni thënë këtë dje në përgjigje të
8 Gjykatësit?

9 Z. ELLIS: [Përkthim] E shoh që po tundni kokën,
10 Dëshmitar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po dëgjon
12 përkthimin akoma dëshmitari, kështu që prisni një çast.

13 DËSHMITARI: Mua më kujtohet pyetja nga Gjykatësi i
14 nderuar për këtë temë. Më kujtohet edhe fjala ime që i kam
15 thënë, sepse të gjithë grupi përfshirë Sali Veselin, Habit
16 Hazirajn, Xhemajli Beqirajn dhe mua, janë liruar të pafajshëm
17 edhe pse pas. Ai është liruar pas katër vitesh, kurse unë jam
18 liruar menjëherë në gjykimin e parë. Dhe prapë e dëshmoj të
19 gjithë grupi janë liruar të pafajshëm edhe pse pak me vonesë.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Do kërkoja që të paraqitet në ekran
21 dokumenti SPOE00125174 deri në SPOE00125190. Në rregull.

22 PY. Është një dokument që është i disponueshëm vetëm në
23 anglisht, kështu që do ju lexoj pjesët përkatëse dhe do ju bëj
24 pyetje lidhur me të. Është një aktgjykim i Gjykatës Supreme të
25 Kosovës mban datën 22 gusht 2007. A e kam kuptuar drejt nga

1 përgjigja juaj, Dëshmitar, se në këtë pikë ju nuk keni qenë i
2 përfshirë në rigjykim? Në këtë pikë juve keni qenë deklaruar i
3 pafajshëm, a është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

4 PË. PO, z. Avokat.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Të kalojmë tek faqja 10 e versionit
6 në PDF. Kalojmë drejt fundit të faqes. Kaq, mjafton.

7 PY. Atëherë, së pari, këtu jepet një përmbledhje e vendimit
8 të rigjykimit dhe thuhet që:

9 "Më 4 gusht 2006 është shqiptuar vendimi me gojë dhe
10 konkretisht thuhet që Sali Veseli është shpallur fajtor ..."

11 Dhe vazhdon më tej në paragrafin tjetër që atij i është
12 dhënë gjithsej 15 vite burgim, pra, vendimi për të është 15
13 vite burgim.

14 A mbase e keni pasur fjalën për këtë vendim, për këtë
15 lëndë gjyqësore kur keni thënë që ai është dënuar me 15 vjet
16 burgim, Dëshmitar?

17 PË. Dhe në vitin 2003, kur unë jam liruar atë ditë më 23
18 mars, mendoj që Sali Veseli është dënuar nuk mbaj mend tash 10
19 apo 15. Mirëpo është dënuar edhe mandejna është rikthyer në
20 rigjykim, mandej ka filluar prapë rigjykimi. E kanë dënuar
21 prapë 15 vjet, e Gjykata e Lartë e ka liruar. Kanë ndodhur
22 shumë gjykime, shumë, shumë seanca. Kështu që edhe sot nuk më
23 kujtohet me saktësi.

24 Mirëpo e di në fund Sali Veseli dhe i tërë grupi janë
25 liruar të pafajshëm. Këtë jam 100 i sigurtë. Nuk e di datën

1 kur është liruar i pafajshëm, por e di që janë liruar të
2 pafajshëm.

3 PY. Faleminderit. Për këtë do ju pyes tani, do ju lexoj katër
4 paragrafë nga vendimi nga aktgjykimi dhe pastaj do ju bëj një
5 pyetje.

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Do kërkoja që së pari të paraqitet
7 në ekran faqja 12.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ishte mirë
9 që të bëjmë një pushim për dhjetë minuta tani për dëshmitarin
10 dhe pastaj kthehemi dhe mund të vazhdoni me leximin dhe me
11 pyetjet e tjera.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Kjo është pyetja e fundit, në fakt,
13 po nga ana tjetër do më duhet të lexoj goxha. Kështu që nuk e
14 di sesi duhet të vazhdojmë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë atëherë.
16 Vazhdoni më tej.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Në rregull. Ju lutem paraqisni faqen
18 12.

19 PY. Po lexoj nga paragrafi i katërt i kësaj faqeje:

20 "Për rrjedhojë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se
21 vendimi i rigjykitimit i 4 gushtit 2006 nga Gjykata Themelore e
22 Prizrenit në lëndën penale P49/04 ka zbatuar në mënyrë të
23 pasaktë të drejtën penale themelore dhe një shkelje të nenit
24 365, paragrafi 4, të Kodit Penal, Kodi i Procedurës Penale.

25 Për këtë arsye, ajo e shpall të pafajshëm të pandehurin Sali

1 Veseli për krimet e lidhjes penale për sa i takon shkeljes së
2 nenit përkatës kodit ...”

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani vazhdojmë më tej. Ju lutem
4 kaloni pak më poshtë në faqe, kjo është faqja 14.

5 PY. Vazhdojmë më tej. Thuhet në të që:

6 “Nuk ka asgjë në aktgjykimin përkatës të datë 4 gusht
7 2006 që sugjeron që Fazlli Neziraj është pajtuar me Sali
8 Veselin që ai do vriste Ekrem Rexhën. Në të kundërtën, flitet
9 për mungesën e marrëveshjes ose pajtimit ndemjet Sali veselit
10 dhe Fazlli Neziraj për sa i takon kësaj çështjeje.”

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Në qoftë se do të vazhdojmë më tej
12 në faqen 15 të të njëjtit aktgjykim. Sekretare, do ju lutesha
13 që të kaloj pak më poshtë në faqe.

14 PY. Po shikoj paragrafin në mes të kësaj faqeje ku thuhet që:

15 “Rigjykimi i 4 ushtit 2006 ka konstatuar që Ekrem Rexha
16 është vrarë më 8 maj 2000. Ka konstatuar po ashtu që të vetmit
17 dy -- të vetmit dëshmitarë që kanë qenë të pranishëm në afërsi
18 të vendit të krimit ka qenë Ruzhdi Rexha, vëllai i Ekrem
19 Rexhës dhe Hajrie Rexha, bashkëshortja e Ekrem Rexhës. Dhe
20 është konstatuar që as Ruzhdi Rexha dhe as Hajrie Rexha nuk
21 kanë qenë në gjendje që të identifikojnë personin që ka
22 qëlluar në drejtim të Ekrem Rexhës.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe, së fundi, në qoftë se do të
24 kalojmë tek faqja 16.

25 PY. Dua t’ju lexoj drejt fundit të faqes ku thuhet që:

1 "Për rrjedhojë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se,
2 me pranimin e vendimit të rigjykimit të 4 gushtit 2006 ka
3 provë të pamjaftueshme për identifikimin e vrasësit të Ekrem
4 Rexhës dhe nuk ka provë të drejtpërdrejtë që konstaton lidhjen
5 shkak-pasojë ndemjet veprimeve të Sali Veselit dhe vrasjes së
6 Ekrem Rexhës, elementët e domosdoshëm të bashkëpunimit për
7 krim për vrasjen e Ekrem Rexhës nuk mund të provohen,
8 rrethanat të cilët vazhdojnë që përjashtojmë veprimin penal".

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Dhe vazhdojmë tek faqja tjetër.
10 PY. "Dhe për këto arsye, gjykata e shpall të pafajshëm të
11 pandehurin Sali Veseli për krimin e vrasjes në shkelje të
12 nenit 30, paragrafi 3 i Kodit Penal të Kosovës ...".

13 Pyetja që kam për ju Dëshmitar është kjo: Këto paragrafë
14 që sapo ju lexova a janë në pajtim me atë çfarë ju kujtohet
15 juve që jo vetëm që është liruar Sali Veseli por ai është
16 shpallur i pafajshëm nga Gjykata Supreme, a e dini dhe ju
17 kështu, a është kjo rrjedha?

18 PË. Po, z. Avokat. Ashtu edhe u mundova të them dje, mirëpo
19 Gjykatësi Mettraux këmbëngulte prapë që është dënuar, dënuar
20 dhe e lashë në të tijën, mirëpo unë e dija se ai është liruar
21 i pafajshëm. Të gjithë, jo ai, të gjithë ata që kanë qenë të
22 akuzuar në atë grup tanë janë liruar të pafajshëm.

23 PY. Faleminderit.

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
25 Nuk kam pyetje tjera.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Dëshmitar, përfunduar me pyetjet tuaja. Nuk keni më
3 detyrim përpara Gjykatës. Faleminderit që ishit me ne gjatë
4 këtyre ditëve. Tani mund të largoheni nga salla e gjyqit.

5 Faleminderit shumë edhe ju, Avokat, për ndihmën e dhënë.

6 Z. KOÇI: E kam tash një kërkesë të cilën e paralajmërova
7 dje, meqenëse klienti im e ka marrë vendimin prej Prokurorisë
8 që kanë pushu hetimet ndaj tij për veprat për të cilat është
9 dyshu. Aty në vendim shkrun që është vendim konfidencial. Unë
10 e kërkoj nga Gjykata që të na bëjë të mundshme që ta bëjë
11 publike që janë pushuar hetimet ndaj tij.

12 Do të thotë, të jem i sigurtë që nuk bën ndonjë shkelje,
13 kërkoj lejen nga Gjykata. Se opinionimi publik e dinë që është
14 ky nën hetime, pasi që veç kanë pushu hetimet.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 Z. KOÇI: Po.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
18 kërkimet e nevojshme lidhur me këtë.

19 Z. Prokuror.

20 Z. PACE: [Përkthim] Për të thënë që kjo ka ndodhur *de*
21 *facto*, kështu që sipas parashtrimeve tona, nuk nevojiten masa
22 të tjera dhe nuk është e nevojshme të bëhen pranime të tjera.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe deklarata
24 është bërë në seancë të hapur? Pra, bota e di, publiku e di.
25 Në rregull. Faleminderit.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
3 pushim për 15 minuta në mënyrë të tillë që të bëni organizimet
4 për dëshmitarin tjetër për të ardhur në sallë. Ju mjaftojnë 15
5 minuta?

6 Z. PACE: [Përkthim] Po. Atëhere sa i takon planifikimit,
7 dëshmitari i radhës është gati, është gati për të filluar
8 dëshminë e tij. Ne mendojmë që nuk do të duhen më shumë se dy
9 orë për këtë dëshmitar. Kështu që mund të kemi gati dhe
10 dëshmitarin e radhës në mënyrë të tillë që të mund të bëjmë
11 përfundimin ose që ta përbyllim ashtu siç keni planifikuar.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Varet nga koha.

14 Do bëjmë pushim për 15 minuta.

15 --- Seanca ndërpritet në orën 10.06

16 --- Seanca rifillon në orën 10.22

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati të
18 fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë me numër
19 W04820.

20 Ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

21 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
23 Dëshmitar.

24 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëgjon mirë?

1 DËSHMITARI: Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
3 Asistentja e Gjykatës do t'ju japi një tekst tani, ky është
4 betimi solemn të cilin duhet ta bëni në bazë të rregullores së
5 Gjykatës rregulla 141(2). Ju lutem lexoni me zë tekstin që
6 keni përpara.

10 të grupeve guerile, pra, a janë diskutuar vërtetë këto tema në
11 mbledhjen në Tiranë që ju kujtohet ju?

12 PË. Saktësisht krejt kjo nuk më kujtohet, por e di që është
13 thënë se në Kosovë ekzistojnë disa grupe të armatosura, duke
14 përfshi edhe atëherë grupin e Adem Jasharit, komandantit
15 legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, grupe tjera si në
16 Llap dhe në Dukagjin dhe që të bëhet unifikimi i këtyre
17 grupeve. Por jo me këto detyra specifike për të cilat është e
18 ka paraqitë ai.

19 Ky është një shkrim, po mendoj, mendoj është i glorifiku
20 sesa i shkruar mbas luftës po më duket, sesa që ka në të
21 vërtetë në këtë.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja të
23 shkoja në paragrafin 5 të Shënimit Përgatitor numër 2 për të
24 parë mos ka një mospërputhje.

25 PY. Dëshmitar, kur e keni diskutuar këtë intervistë, ju keni

1 thënë që nuk e keni kuptuar që ky takim ishte takimi ku u
2 krijua UÇK-ja, por ama thatë që temat që keni diskutuar ishin
3 pikërisht të njëjtat tema që përmend dhe Azem Syla, a është
4 kështu?

5 PË. Po, po jo të gjitha këto që i ka përmend. Unë thashë, e
6 kam thënë edhe në seancën përgatitore, se unë kryesisht
7 udhëzime për të bë bashkimin e këtyre grupeve të cilat janë të
8 armatosura, siç janë kanë këto grupet tash në atë kohë, ishte
9 grupi i Drenicës, grupi i Llapit edhe Dukagjinit.

10 PY. Faleminderit.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshmitari
12 konfirmon që është mbajtur kjo mbledhje, ka dhe një intervistë
13 me titullin "Anëtarët e NKP-së pas periudhës së aktakuzës". Ne
14 mendojmë që artikulli është relevant, ka vlerë provuese për
15 këtë çështje gjyqësore dhe kërkojmë që të pranohet.

16 Në fakt kjo është një pjesë e një dokumenti që është edhe
17 më i gjatë, intervista është e gjatë nëntë faqe dhe ka numrin
18 ERN 067707-067710 që ne gjykojmë se duhet pranuar për të
19 kuptuar krejt kontekstin.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Ne e kundërshtojmë. Mund ta
21 dorëzojmë këtë kërkesë përmes mocionit për prova jo gojore,
22 por dëshmitari në fakt nuk ka konfirmuar asgjë, përkundrazi e
23 konteston saktësinë e kësaj intervistës. Dhe unë nuk e pranoj
24 që të pranohet materiali në këtë formë.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Nëse materialet pranohet sipas

1 provave jo gojore, atëherë do pranohet materiali pa komentuar
2 fare dëshmitari. Po ne mendojmë që kontekstualizimi i
3 dëshmitarit është shumë i rëndësishëm për ta kuptuar
4 intervistën si të tërën.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë nuk po them që ta pranoni
6 përmes mocionit jo gojor automatikisht. Por le ta bëjnë
7 mocionin dhe ne kundërpërgjigjemi.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Mbështes edhe unë parafolësin. Pjesa
9 që ju lexua dëshmitarit është e rëndësishme, okej, e kuptojmë.
10 Por nuk është kjo mënyra e duhur që duke i lexuar disa pjesë
11 dëshmitarit të kërkohet të pranohet materiali në tërësinë e
12 vet.

13 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne do
15 pranojmë të nëntë faqet, po jo të gjithë dokumentin,
16 domethënë, jo nga fillimi deri në fund të dokumentit.
17 Megjithatë nuk jam shumë i sigurtë se cilat janë numrat për
18 këto nëntë faqe. Kështu që do ju kërkoja të jepnit faqet,
19 Prokuror.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Sepse mendoj që versioni në
21 shqip është një artikull gazete dhe në anglisht kërkohen disa
22 faqe që reflektojnë përkthimin e tij. Faqet për të cilat bëhet
23 fjalë, konkretisht është 067707 deri në 067710. Ky është
24 dokumenti fundit dhe këto faqe kërkojmë që të pranohen në
25 prova gjyqësore.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të nënta
2 faqet do të pranohen sepse përmbushin standardin *prima facie*
3 të rregullës 138.

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i caktohet numri i
5 provës P01875 dhe aktualisht klasifikohen si konfidenciale.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
7 vazhdoni.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të klasifikohen si publike.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
10 Riklasifikojini si publike.

11 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
12 Gjykatës.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Tani mund ta hiqini dokumentin nga
14 ekrani.

15 PY. Dëshmitar, duke folur tani për fillimet e UÇK-së dhe
16 dëshiroj që të përqendrohemi tani tek Shtabi Qendror i cili më
17 pas u bë Shtabi i Përgjithshëm. Cilët ishin anëtarët kryesorë
18 të asaj që më vonë u bë Shtabi i Përgjithshëm?

19 PË. E ke fjalën për Shtabin Qendror? Pyetja?

20 PY. Po.

21 PË. Unë Shtabin Qendror ka qenë Azem Sylja, unë, Xhavit
22 Haliti, Nait Hasani, më duket dhe Ali Ahmeti.

23 PY. Po Xheladin Gashi a ka qenë një prej anëtarëve të parë,
24 po ashtu?

25 PË. Po. Po, s'e nuk e thashë. Në atë kohë, një sqarim, nëse

1 mundem, në atë kohë është kërkuar nga Xheladin Gashi që të
2 jepen tre emra brenda Kosovës dhe tre emra të jenë nga jashtë
3 Kosovës për këtë Shtab Qendror. Dhe ai ka dërgu emrin tim dhe
4 emrin e Nait Hasanit. Ndërsa atje kemi mësuar se është Azem
5 Syla, Xhavit Haliti dhe Ali Ahmeti, më duket Ali Ahmeti.
6 PY. E kuptova. Tani dua që të flasim për 1996 dhe dua -- në
7 1997 - më falni - dhe dua që t'ju pyes për një rast ose një
8 incident që është përshkruar ndërmjet vendeve të tjera dhe në
9 intervistën e Rexhep Selimit.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë arsye do i kërkoja
11 Sekretarit që të paraqesë në ekran dokumentin SPOE00131824
12 deri në 00131857-ET. Versioni i faqes së parë në shqip është
13 SPOE00131751, në qoftë se është më i thjeshtë për t'u gjetur
14 nga sekretari. Ndërkohë që faqja që dua që të transmetoni në
15 ekran është ajo që mban numrin SPOE00131832. Dhe sa për
16 plotësinë e informacionit, më duhet të them që fletë të tjera
17 ose faqe të tjera të këtij dokumenti janë pranuar dhe kanë
18 numrin e provës P1857, por faqja që unë do kërkoj që të
19 paraqitet tani nuk është pranuar në provë.

20 Atëherë ajo çfarë kemi në ekran në versionin në anglisht
21 është e qartë. Ndërkohë që versioni më i plotë për versionin
22 në shqip mban numrin SPOE00131751.

23 PY. Kur të shfaqet fleta e intervistës do ju lexoj një pjesë
24 një herë të kësaj interviste dhe pastaj do ju bëj një pyetje
25 lidhur me të, Dëshmitar.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Faqja konkrete dhe një herë është
2 SPOE00131832. Të kalojmë në fund të faqes në të dyja versionet
3 në anglisht dhe në shqip.

4 PY. Në fund fare thuhet, pra, Rexhep Selimi thotë si më
5 poshtë në fund fare:

6 "Pas këtyre të trejave kishte edhe disa persona të tjerë
7 të cilët janë sjellë nga Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli në
8 Jabllanicë, pra, shtatë mortaja dore u sollën aty nga këta të
9 dy. Ne kishim 11 prej tyre. Kishim dhe tri të tjera të cilat
10 kanë ardhur në forma të tjera dhe i bëmë 14, për të përgatitur
11 14 aksione të 11 shtatorit të vitit 1997. Deri në atë ditë ne
12 nuk kemi përdorur asnjërën prej tyre, prej këtyre mortajave,
13 ndonëse kishim nevojë t'i përdornim me qëllim që Serbia të mos
14 merrte masa sepse në atë kohë llogarisnim se kjo është një
15 armë e madhe dhe dëshironim ta zinim Serbinë në befasi, ashtu
16 si në fakt e zumë duke organizuar një aksion shumë të fuqishëm
17 dhe të sinkronizuar në shtator të vitit 1997. I patëm 14
18 mortaja dhe i bëmë 14 aksione. Sikur të kishim 20 mortaja do
19 kishim bërë 20 aksione."

20 Dëshmitar, pyetja e parë që kam për juve është kjo: A
21 jeni ju të njohur me aksionet e sinkronizuara në stacionet ose
22 rajonet e policisë që janë përshkruar nga Rexhep Selimi tek
23 kjo pjesë e intervistës së tij?

24 PË. Kjo është një intervistë. Nuk po muj me paragjyku nëse
25 është glorifikuese apo jo, kështu është dashtë me paraqit një

1 organizim ma të mirë të asaj kohe, por unë pjesë e këtyre
2 sulmeve nuk kam qenë. Aksione kanë ndodhur mesa di. Por të
3 jenë kanë të sinkronizune, domethënë, që të jenë ka kështu kaq
4 shumë njëkohësisht nuk e mbaj mend.

5 PY. Në rregull.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretarit që të
7 paraqesë provën P279 në të dyja versionet në shqip dhe në
8 anglisht. Të presim për një çast që të shfaqet edhe versioni
9 në anglisht i këtij dokumenti në ekran.

10 PY. Megjithatë, sikur mund ta shikoni nga ajo që keni përpara
11 ekranit, kemi të bëjmë me një artikull që ka të bëjë me
12 Komunikatën numër 36.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Për ta ndihmuar më tej Sekretarin
14 do jepja edhe numrin ERN që është SPOE00209309 që përfundon me
15 -ET *Revised*.

16 PY. Dëshmitar, a e njihni këtë si komunikatë të UÇK-së?

17 PË. Jo, s'më kujtohet.

18 PY. Do lexoj fillimin e saj:

19 "Më 11 dhe 12 shtator 1997 me vendim të Shtabit Qendror
20 njësitet e armatosura të UÇK-së kryen një aksion të
21 sinkronizuar në Zonën Operative numër 1."

22 Më pas thuhet që:

23 "Aksionet u kryen po ashtu edhe me një shpejtësi shumë të
24 madhe në disa stacione policore", dhe këtu jepen edhe vendet
25 ku kanë ndodhur, jepen vendet e këtyre stacioneve policore.

1 Në Shënimin Përgatitor 1 ju thatë, Dëshmitar, që Rexhep
2 Selimi nuk ka pasur mundësi që të bëjë ndonjë gjë në Shtabin
3 Qendror në vitin 1997. A ju kujtohet ta keni thënë këtë,
4 Dëshmitar?

5 PË. Po, sipas informacioneve të mia. Ne s'kemi nejt në atë
6 kohë, s'jemi takuar me të shpesh.

7 PY. Kjo komunikatë a tregon që UÇK-ja kishte mundësi që të
8 kishte operacione ose aksione të armatosura që të kryente
9 aksione të tilla në vitin 1997, a është e saktë kjo?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja që
11 të jepte referencën në Shënimin Përgatitor numër 1 Prokurori.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Është prova P1873 -- jo, e
13 thashë gabim. P1872, është paragrafi 5, pra, konkretisht këtu
14 thuhet që:

15 "Dëshmitari nuk beson që Rexhep Selimi ka pas mundësi që
16 të bëjë ndonjë gjë në Shtabin Qendror në vitin 1997."

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam edhe një çështje procedurale,
18 do të duhet që ta trajtojmë më vonë që tani kjo është
19 diskreditim i dëshmitarit dhe ajo çfarë është në dëshmi tani
20 sepse është dëshmi thelbësore.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe unë kundërshtoj sepse janë
22 pyetje që nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën. Nuk ka dëshmi që
23 jepet sa i takon me rolin e z. Selimi në Shtabin Qendror deri
24 tani.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë gjë po pyesim dëshmitarin

1 që të komentojë. Këto janë tema që në qoftë se doni t'i
2 shtjelloni më tej mund t'i pyesni gjatë pyetjeve tuaja.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të bëj një koment procedural.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Doni që të
6 largohet dëshmitari nga salla.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbase do ishte më mirë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
9 mund të dilni nga salla për pak minuta. Do ju shoqërojë
10 Sekretari për të dalë nga salla.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Qerkini,
13 në qoftë se dëshironi mund të dilni dhe juve ose mund të
14 qëndroni në qoftë se doni.

15 Mund të vazhdoni z. Misetic.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, thjesht dua që të them diçka
17 lidhur me rregullat. Por mënyra sesi e kuptoj unë është që
18 Prokuroria po e diskrediton dëshmitarin lidhur me paragrafin
19 5.

20 Por qëndrimi ynë është që diskreditimi konkretisht
21 parashikohet në rregulle 143. Sipas interpretimeve të dhëna
22 nga Trupi Gjykses sa i takon një deklaratë që përbën objekt
23 diskreditimi sipas rregullës 143, kjo përcaktohet në ligj ose
24 e thënë më qartë është që është precedenti i këtij Trupi
25 Gjykses që ka përcaktuar që është një deklaratë e dhënë në

1 kontekstin e një hetimi penal.

2 Kështu që, qëndrimi ynë është, së pari, duhet të kërkon
3 leje për diskreditimin e dëshmitarit sipas rregullës 143 dhe,
4 së dyti, nuk mund të përdorni një material të ngjashëm me këtë
5 për të diskretituar dëshmitarin mbështetur në atë çfarë ka
6 përcaktuar Trupi Gjykses se çfarë përbën diskreditim të një
7 dëshmitari.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A synoni që
9 të diskreditoni dëshmitarin?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Do thoja jo akoma, megjithëse në
11 atë drejtim po shkojmë. Për momentin duam që të mundohemi që
12 të eksplorojmë më tepër atë çfarë di dëshmitari lidhur me këtë
13 incident.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë kështu e
15 kisha kuptuar dhe unë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se jemi në një
17 zonë gri këtu. Por qëndrimi ynë është që kur një palë e
18 thërret një dëshmitar dhe e parashtron dëshmitë e dëshmitarit
19 dhe kërkon dëshmi të drejtpërdrejta nga dëshmitari, pala në
20 qoftë se nuk autorizohet sipas rregullës 143 nuk mund të
21 kërkojë diskreditimin sepse mendohet që dëshmitari thotë të
22 vërtetën sa i takon përmbajtjes së tij.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju thatë që
24 thjesht ta thoni, ta bëni të qartë pozicionin tuaj.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë e bëtë e
2 kuptoj.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Ne rezistojmë këtë pjesën
4 hipotetike, por megjithatë kur të kalojmë tek pjesa praktike
5 do ta bëjmë të qartë atë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Mund të sillet përsëri dëshmitari në sallë.

8 [Dëshmitari vijon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
10 vazhdoni.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
12 PY. Dëshmitar, besoj që duhet që ta përsërisë edhe një herë
13 pyetjen se s'besoj se e mbani mend. Po flisnim për komunikatën
14 që është përpara në ekran dhe unë ju pyeta në qoftë se kjo
15 komunikatë tregon që UÇK-ja kishte aftësi që të bënte aksione
16 të armatosura dhe ishte e organizuar në vitin 1997, a ishte
17 kështu?

18 PË. Unë e thashë dhe në fillim se këtë komunikatë nuk e kam
19 parë. Nuk e njoh. Për arsye se komunikatat në atë kohë me
20 siguri janë shkru jashtë. Se nuk e di kush i ka shkruar
21 komunikatat dhe nuk e di saktë sa e pasqyron një realitet të
22 ndodhur në këtë kohë në Kosovë.

23 PY. Në përgjigjen më të hershme që keni dhënë dhe kjo për
24 procesverbal jepet në faqet 78 të transkriptit në kohë reale,
25 ju thatë që:

1 "Aksioni është kryer mesa di unë."

2 Pyetja që kam për juve është kjo: Nga e dini ju që është
3 kryet ky aksion, nga e dini këtë gjë?

4 PË. Po këto përmes mediave të ndryshme. Ka qenë media.

5 PY. A ju kujtohet ndonjë media konkrete ku e keni parë këtë,
6 Dëshmitar?

7 PË. Jo, për besë. Nuk e di.

8 PY. A ju kujtohet që në qoftë se në media kur e keni parë në
9 atë kohë e keni parë si sulm të sinkronizuar?

10 PË. Nuk më kujtohet.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga
12 ekrani, Sekretar dhe në vend të tij do ju kërkoja që të
13 paraqisni dokumentin 099794 deri në 099797, vetëm faqen e parë
14 të këtij dokumenti në versionin në shqip dhe në anglisht.

15 PY. Dëshmitar, ndërkohë që shfaqet ky dokument, ky është një
16 dokument tjetër që jua kemi treguar gjatë seancës përgatitore
17 dëshiroj që ta shikojmë njëherë pastaj do ju bëj disa pyetje.

18 Në fillim thuhet:

19 "Intervistë e dhënë nga Sokol Bashota për Zërin e Kosovës
20 në Prishtinë më 25 dhjetor 1998."

21 Pyetja e parë për ju është kjo: A është intervista jua
22 kjo, Dëshmitar?

23 PË. Në dukje po. Po.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, për procesverbal
25 -- ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres, Prokuror. Por për të qenë

1 i qartë në anglisht thuhet ajo çfarë tha Prokurori, por në
2 shqip nuk thuhet kjo gjë. Pra, me fjalë të tjera dëshmitari
3 nuk e shikon atë çfarë tha Prokurori. Pra, në fillim fare
4 titulli nuk është "Intervistë e dhënë nga Sokol Bashota".

5 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk mendoj që kjo ka lidhje me
6 përgjigjen e dëshmitarit, përgjigjen që i dha pyetjes time se
7 atë e dha dhe është në procesverbal.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
9 vazhdoni.

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, a keni pasur mundësi që të rishikoni
12 përmbajtjen e kësaj interviste gjatë seancës përgatitore me
13 ne?

14 PË. Po. Po.

15 PY. A ka pasur kjo intervistë ndonjë informacion që e patë
16 dhe që ka qenë informacion fals ose i rremë që keni dhënë në
17 këtë intervistë ju?

18 PË. Të rremë jo. Po jemi munduar për media zakonisht shkrimet
19 që i kem i bë dhe që i kemi publiku jemi munduar që ta
20 paraqesim organizimin tonë ushtarako-politik të Ushtrisë
21 Çlirimtare të Kosovës sa më mirë në mundësinë e mundshme për
22 opinionin e brendshëm.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Të kalojmë më poshtë në faqe në
24 shqip, vetëm tek faqja e parë e intervistës dhe në qoftë se do
25 shkojmë nga fundi i faqes do shikoni që ka disa shënime me

1 shkrim dhe anash, në fakt, janë këto shënimet me shkrim. A

2 është shkrimi juaj i dorës ky, Dëshmitar?

3 PË. Ah, nuk e di. S'e di.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Ta heqim nga ekrani dokumentin

5 tani dhe në vend të tij të vendosim dokumentin SPOE400014.

6 Është një dokument prej një faqeje, ju lutem paraqisni

7 dokumentin në shqip dhe në anglisht.

8 PY. Dëshmitar, a keni pasur mundësi që të rishikoni

9 përmbajtjen e këtij artikulli në seancën përgatitore me ne?

10 PË. Po.

11 PY. Pra, ajo çka kemi këtu është një intervistë, është Haki

12 Morina që ka bërë një intervistë me juve në Zërin e Kosovës.

13 Data këtu është 31 dhjetor 1998. A është kjo e njëjta

14 intervistë si intervista që patë në dokumentin e mëparshëm?

15 PË. Nuk e di. Nuk muj me krahasu. Nëse është teksti i njëjtë,

16 mund të jetë kjo.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se na lejoni për t'i

18 rifreskuar kujtesën dëshmitarit në paragrafin 9 të Shënimit

19 Përgatitor numër 2.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, vazhdoni.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk dua që ta

22 kalojmë të gjithë përmbajtjen këtu përpara Gjykatës.

23 PY. Por në seancën përgatitore ju thatë që pavarësisht

24 formatimit janë versione të njëjtës interviste tuajën kjo --

25 PË. Po, po.

1 PY. -- që keni përpara në ekran edhe dokumenti i mëparshëm.

2 Dhe pyetja tjetër që jua bëra dhe më herët lidhur me
3 dokumentin tjetër është që a keni identifikuar ndonjë
4 formacion që ishte i rremë në këtë intervistë?

5 PË. Të rremë jo. S'e besoj. Nuk e besoj.

6 PY. Dua t'ju pyes lidhur me diçka që keni thënë që, në fakt,
7 jepet në faqen 2 të versionit në PDF në anglisht. Juve ju
8 bëhet një pyetje nga intervistuesi. Ai ju thotë:

9 "Çfarë mund të thoni lidhur me veprimtaritë e hershme dhe
10 periudhën deri në prezantimin e parë të UÇK-së për publikun
11 ... më 28 nëntor 1997?"

12 Mbase është e vështirë për të parë përgjigjen në ekran
13 për shkak të shkrimit të vogël, megjithatë do të lexoj pjesën
14 për të cilën jam i interesuar dhe mund ta dëgjoni përmes
15 përkthimit. Pra, kur ju është bërë kjo pyetje, ju keni thënë:

16 "Ne kemi vepruar në mënyrë efikase dhe siç duhet për të
17 ndjekur rastin tonë. Në të gjitha rastet kishte plane të
18 aksioneve, të operacioneve që kanë qenë të sakta dhe kemi
19 pasur mundësi që të ndërmarim aksione në tetë deri në 12
20 vende në Kosovë në të njëjtën minutë. Çdo ditë që kalonte ne
21 bëheshim më shumë profesionalë dhe më të strukturuar për të
22 arritur standardet, nivelet e ushtrisë standarde."

23 Atëherë sa i takon kësaj që thoni ju këtu, që kishit
24 aksione nga tetë deri në 12 vende, a ishte kjo pjesë e
25 aksioneve të sinkronizuara kundër stacioneve policore serbe në

1 vitin 1997?

2 PË. Po, duke u nisur nga ato informacione që kam mujt me i
3 marr përmes mediave dhe ju kam referu pikërisht atyre.

4 PY. Në rregull.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Trupi Gjykses
6 ka thënë në vendimin me numër F01983 që i pari prej dy
7 versioneve të intervistave të treguara që është 099794 deri në
8 099797 ka nevojë për informacion të mëtejshëm për sa i takon
9 origjinës së burimit të dokumentit të mëparshëm për t'u
10 pranuar. Dëshmia e dëshmitarit sot lidhur me versionin e
11 artikullit të gazetës, pra, përsëri bëhet fjalë për dokumentin
12 SPOE40000014, jep themel shtesë sa i takon intervistës dhe
13 besueshmërisë. Ne kërkojmë që të pranohet ajo në prova
14 gjyqësore.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
16 kundërshtime?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, kemi ne kundërshtim, nuk e
18 kemi të qartë se pse kërkohet që të pranohet dhe versioni i
19 dytë ndërkohë që ekziston artikulli i parë i pranuar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Dokumenti 099794 deri në 099797 dhe SPOE40000014 pranohen
22 si prova gjyqësore. Duhet që të marrin një numër prove të dyja
23 së bashku dhe të dy dokumentet përmbushin standardet e
24 parashikuara në rregullën 138.

25 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës

1 këshillohen]

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
3 faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 [Përkthim] A ka ndonjë arsye që pse doni që këto
6 dokumente të marrin dy numra të ndryshëm provash gjyqësore? E
7 di kundërshtimin tuaj, po thjesht dua të di në qoftë se keni
8 një arsye që pse mendoni që të duhet të kenë dy numra të
9 ndryshëm.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se do të pranohen mendoj
11 që duhet të mbajnë dy numra të ndryshëm provash gjyqësore
12 sepse nuk e kemi të qartë akoma se pse kërkohen që të dyja të
13 pranohen në prova gjyqësore.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Do caktojmë dy numra të ndryshme provash gjyqësore për të dy
16 dokumentet.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
18 Gjykatës. Në këtë rast dokumenti 099794 deri në 099797 dhe
19 përkthimi në anglisht do të marrin numrin e provës P01876.
20 Është dokument i cili aktualisht është i klasifikuar si
21 konfidencial.

22 Sa i takon dokumentit tjetër me numër SPOE40000014 dhe
23 përkthimi përkues në anglisht do të marri numrin e provës
24 P01877. Dhe ky dokument aktualisht është i klasifikuar si
25 publik.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të
2 riklasifikohet si publik edhe dokumenti i parë?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
5 Riklasifikoheni dokumentin 1876 si publik.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Do bëhet.

7 Z. HALLING: [Përkthim] E di që kemi dhe pak minuta
8 përpara sesa të bëjmë pushimin, po besoj që mund të bëj ca
9 pyetje tjera ndërkohë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Mund ta
11 përdorni kohën që keni në dispozicion.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të seancës
13 tani të paraqesë në ekran dokumentin 00209301 në shqip dhe në
14 anglisht.

15 PY. Ndërkohë që shfaqet ky dokument, Dëshmitar, në
16 intervistën e fundit që ju tregova që keni dhënë ju bëheshin
17 pyetje të lidhura me aktivitetet ose veprimtaritë e para të
18 UÇK-së deri në daljen e vet publike më 28 nëntor 1997. Atëherë
19 pyetja e parë është kjo: Kur ka qenë dalja e parë publike e
20 UÇK-së në vitin 1997?

21 PË. Dalja e parë publike ka ndodhur më 28 nëntor të 1997 mbas
22 një vrasjeje që është bërë në Llaushë, Halit Gecit kujtoj
23 emrin më duket, mbas vrasjes së Halit Gecit, në tubimin mortor
24 të tij.

25 PY. Kush ka qenë i pranishëm nga UÇK-ja në këtë daljen e parë

1 publike të UÇK-së?

2 PË. Të pranishëm mund të kenë qenë shumë, por njoh vetëm ata
3 të tre të cilët -- tre veta të cilët kanë dalë për të bërë,
4 lexu një deklaratë politike.

5 PY. Mund të na i thoni emrat e këtyre tre personave?

6 PË. Mujë Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Daut Haradinaj.

7 PY. Kush ka folur në atë rast?

8 PË. Ka folur Rexhep Selimi.

9 PY. Tani të kalojmë tek dokumenti që keni përpara në ekran.
10 Nuk do e lexoj të gjithin sepse është një dokument të cilin ua
11 kemi treguar në seancë përgatitore. Po thjesht mund ta lexoj
12 pjesërisht:

13 "Ka katër vite që UÇK-ja është në pararojë të luftës për
14 çlirimin e Kosovës. Ka kryer disa aksione çliruese kundër
15 okupatorëve në vende sensitive si dhe kundër bashkëpunëtorëve
16 shqipfolës, kolaboracionistëve."

17 Nga rishikimi që bëtë përpara një jave a është ky teksti
18 i daljes së parë publike të UÇK-së?

19 PË. Po tash nuk muj me kuptu, kujtu krejt, po diçka e
20 ngjashme po.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky është një
22 dokument që nuk është pranuar, domethënë, pranimi i tij është
23 rrëzuar nga Trupi Gjykses në vendimin F01715, sepse u tha që
24 ka nevojë për kontekstualizim nga një dëshmitar. Tani
25 kontekstualizimi është këtu, kështu që kërkojmë pranimin e

1 këtij dokumenti.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
3 kundërshtim?

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
6 SPOE00209301 pranohet.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
8 provës gjyqësore 01787. Dhe klasifikohet si publik.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shikoj kohën
10 që ka ardhur koha e pushimit të drekës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
12 bëjmë pushimin e drekës tani për një orë e gjysmë. Mund të
13 largoheni nga salla e gjyqit deri në orën 2.30.

14 Ta dini që nga ora 2.30 deri në 4.30 do të kemi seancë
15 sot dhe në 4.30 do ta mbyllim për sot, sa për informim është
16 kjo.

17 Mund të largoheni tani së bashku me Asistenten.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] faleminderit,
20 z. Qerkini. Mund të largoheni dhe ju.

21 Do bëjmë pushim deri në orën 2.30.

22 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

23 --- Seanca rifillon në orën 14.31

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
25 sillni dëshmitarin në sallë.

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
3 vazhdojmë me pyetjet nga ana e Prokurorisë.

4 Z. Halling, fjala është për ju.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Dhe mirëdita, Dëshmitar.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Si fillim --

8 DËSHMITARI: Mirëdita.

9 Z. HALLING: [Përkthim] -- do t'i kërkoj Sekretarit të
10 seancës të nxjerrë në ekran materialin me numër SPOE00052992
11 deri në 00053035-ET Revised. Ndërsa shqipja është me numër
12 SPOE00052989. Faqja që duam për të dyja versionet është
13 SPOE00053010.

14 PY. Dëshmitar, ndërkohë që presim të dalë dokumenti në ekran
15 do t'ju jap pak kontekst.

16 Kjo është një intervistë që i ka dhënë Kadri Veseli Baton
17 Haxhiut në 2009 dhe është botuar në 2013.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal disa faqe të
19 tjera të kësaj interviste janë pranuar tashmë si pjesë e
20 provave gjyqësore dhe kanë marrë numrin P1859, por faqja që do
21 shohim ne nuk është pranuar ende.

22 Ka dalë materiali në ekran, por ju lutem të vendosni
23 faqen SPOE00053010.

24 PY. Dëshmitar, dua të shohim një përgjigje që ka dhënë Kadri
25 Veseli në këtë intervistë dhe më pas do t'ju bëj disa pyetje.

1 Z. Haxhiu e pyet:

2 "Kur është bërë shef i SHIK-ut?"

3 Dhe ai është kthyer në vija të përgjithshme. Thotë:

4 "Në fakt, përgjegjësitë ne i kemi pasur gjatë gjithë
5 kohës së luftës në periudhën '92-'98. Ne kemi pasur Shtabin e
6 Përgjithshëm dhe Shtabin Operativ të UÇK-së. Specifikisht me
7 informacione nuk kemi pasur atë ndarjen por ... jemi marrë të
8 gjithë me gjithçka. Jemi marrë me leadership, me logjistikë dhe
9 me informacione se ashtu të tilla kanë qenë rrethanat."

10 Dëshmitar, pyetja ime është kjo: Ajo që po thotë Kadri
11 Veseli këtu për ndarjen e përgjegjësive, a përputhet dhe me
12 mënyrën si e keni kuptuar ju funksionimin e leadershipit të
13 UÇK-së?

14 PË. Nëse i referohet vitit '92-'98 unë nuk besoj që është e
15 saktë ky konstatim, për vetë faktin se mundësitë për ndarje të
16 detyrave specifike nuk ka pas edhe nuk janë bë.

17 PY. Do ta bëj pyetjen në një formë tjetër. Kur flet këtu
18 Kadri Veseli për detyrat e ndryshme në të cilat ka qenë i
19 përfshirë, Shtabi Operativ i UÇK-së, a ka funksionuar përveç
20 vendimeve të përbashkëta apo kolegiale?

21 PË. Shtabi i Përgjithshëm, po, por shtabi operativ është
22 drejtor -- janë drejtoritë e janë komandantët e zonave.

23 PY. Të fokusohemi te Shtabi i Përgjithshëm, ju lutem. Këto
24 vendime kolektive apo kolegiale, ndër këto vendime - më falni
25 - a përfshiheshin dhe vendime që kishin me lidhje me masa

1 ndëshkimore kundër kolaboracionistëve?

2 PË. Nuk më kujtohet ndonjë rast se Shtabi i Përgjithshëm ka
3 vendosur për masa ndëshkimore ndaj kolaboracionistëve ndonjë
4 rast të veçantë.

5 PY. Dëshmitar, shkojmë tani dhe shohim një pjesë të
6 deklaratës suaj që është pranuar tashmë si pjesë e provave
7 gjyqësore.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Materiali tashmë ka marrë numrin e
9 provës P1870.6 dhe është faqja 13.

10 PY. Është e shkurtër; thjesht po jua lexoj. Ju është bërë
11 pyetje:

12 "Nëse një kolaboracionisti vazhdonte me veprimtaritë e
13 veta, a ishte autorizuar komandanti i zonës ta urdhëronte
14 vrasjen e tij?"

15 Ju jeni përgjigjur:

16 "Siç ju thashë më herët ka qenë Shtabi i Përgjithshëm që
17 në baza kolegiale ka vendosur lidhur me masat ndëshkimore që
18 do të merreshin kundër kolaboracionistëve armiq."

19 A është kjo dëshmia juaj?

20 PË. I nderuar Prokuror, më lejoni që të shpjegoj atë çfarë e
21 kam thënë në një intervistë që e kam dhënë për tribunalin në
22 rastin e z. Haradinaj. Këtu kam pas parasysh gjithmonë kur
23 janë nxjerrë komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm për këto
24 kategori specifike dhe në gjenerale e kam kuptuar se ata duhet
25 të ndëshkoheshin, të paralajmërohen, përmes komunikatave, por

1 nuk ka pas një urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të veçantë
2 për asnjë bashkëpunëtor, kolaboracionist siç po quhet këtu për
3 vrasjen e tyre.

4 Gjithmonë fjalën e kam pas për ata të cilët ia kanë
5 kthyer pushkën ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
6 pra, janë konë në flagrancë. Vetëm për këto raste dhe jo për
7 rastet e veçanta.

8 PY. Dëshmitar, nuk iu përgjigjët saktësisht pyetjes sime, në
9 fakt. Unë po ju pyes, a ka qenë Shtabi i Përgjithshëm që
10 vendoste në mënyrë kolegjiale lidhur me masat ndëshkimore që do
11 të merreshin kundër kolaboracionistëve armiq? Mund të
12 përgjigjeni me "po" apo me "jo."

13 PË. Jo, nuk kemi, nuk kemi marrë asnjë masë.

14 PY. Kur ju është dhënë mundësia të korrigjoni deklaratën
15 javën e kaluar, përse nuk e korrigjuat atëherë këtë pjesë?

16 PË. Unë thashë për masat, për masat ndëshkimore. Nuk kemi,
17 nuk kemi as edhe një dokument të shkruar për raste të veçanta
18 [E pakuptueshme]. Për raste në gjenerale, po. Iu është bërë
19 thirrje herë pas here iu është bë thirrje të gjithëve që të
20 mos bashkëpunojnë me armikun. Pastaj ka qenë përgjegjësi e
21 komandantëve të zonave për veprimet më tutje.

22 PY. Po ju ndjek. E kuptova tani. Kjo që sapo përshkruat ju, a
23 ishte një mendim kolektiv i Shtabit të Përgjithshëm?

24 PË. Po besoj se ka qenë mendim kolektiv.

25 PËRKTHYESI: Vendim - më fal.

1 Z. HALLING: [Përkthim]

2 PY. Faleminderit.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të hiqet dokumenti nga
4 ekrani.

5 PY. Keni përmendur shpesh kolaboracionistët në dëshmitë
6 tuaja. Janë disa aspekte të dëshmisë suaj lidhur me
7 kolaboracionistët që dua t'i trajtojmë së bashku. Kam pesë
8 fusha të ndara lidhur me këtë. Pjesa e parë është publiciteti.

9 Ja, pyetja ime është kjo: Shtabi -- a ka qenë qëllimi i
10 Shtabit të Përgjithshëm ku lëshonte komunikata kundër
11 kolaboracionistëve; a ka qenë, pra, një nga qëllimet që ta
12 bënte të qartë që askush nuk duhet të veprojë në këtë mënyrë?

13 PË. Të nderuar Prokurorë, në kohë lufte kryesisht edhe armiku
14 i ngjall më shumë apo i fokuson më shumë bashkëpunëtorët e vet
15 për me hy në territoret e të palës tjetër. Dhe zakonisht këta
16 kanë paraqitur një rrezik të madh edhe për luftën e shenjtë të
17 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, luftën e popullit shqiptar.
18 Prandaj edhe kanë qenë të rrezikshëm në fushë-veprimtarinë e
19 tyre.

20 PY. Shumë e dobishme. Nuk ishte pikërisht kjo pyetje ime. Po
21 unë po them, qëllimi i komunikatave, cili ishte në raport me
22 kolaboracionistët? A mos kishte për qëllim që t'i shkurajonte
23 personat e tjerë që të bënin të njëjtën gjë?

24 PË. Qëllimi, qëllimi kryesor i tyre ka qenë që ata të mos
25 bashkëpunojnë me pushtuesin. Ka qenë paralajmëruese.

1 PY. E kuptova. Fusha e dytë është fusha që unë po e quaj
2 detyrat. Shër -- më falni, po e bëj edhe një herë pyetjen.

3 Ka pasur diçka në seancën përgatitore për të cilën
4 dëshiroj t'ju pyes. Në provën gjyqësore P1873, në paragrafin
5 16, ju thoni kështu:

6 " Politi -- Komunikatat ishin deklarata politike që i
7 drejtoheshin popullatës në mënyrë që të ishin të përgatitur."

8 Ju lutem, a mund ta shtjelloni pak më shumë, çfarë keni
9 dashur të thoni ju me fjalën që popullata të ishte e
10 përgatitur?

11 PË. Po komunikatat nuk kam mujt me i përcjellë të gjitha apo
12 as shumicën ndoshta, por për ato çfarë kam pa, është bërë
13 thirrje të gjithë qytetarëve për punën e luftës e Ushtrisë
14 Çlirimtare të Kosovës dhe njëkohësisht në ato komunikata ka
15 pas edhe thirrje edhe për ata të cilët e dëmtojnë luftën e
16 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe popullit shqiptarë mos me,
17 mos me e dëmtu. Në një mënyrë që është bërë thirrje për jo
18 vetëm për një kujdes, por edhe thjesht të mos e dëmtohet
19 lufta.

20 PY. Faleminderit. Sikurse po ju thoja, fusha e dytë është
21 fushë që unë e kam emërtuar detyrat. Tani unë dëshiroj t'ju
22 pyesja: Shërbimi informativ i UÇK-së, a mblidhte informata për
23 personat me interes?

24 PË. Nëse më lejohet, thashë me e shpjegu para se me dhënë
25 këtë përgjigje për shërbimin informativ nja dy-tre rreshta.

1 Falemiderit.

2 Edhe sot e kësaj dite nuk e kam kurrë të kjartë se
3 realisht cilat janë detyrat e shërbimit informativ, cilat janë
4 detyrat e shërbimit për zbulim, detyrat e shërbimit
5 inteligjent apo ato për kundërzbulim. Dhe realisht është një
6 fushë që s'më ka interesu kurrë dhe nuk i njoh rrethanat dhe
7 punët e këtyre shërbimeve. Dhe nuk e di nëse këto janë të
8 ngjashme apo e kanë detyra specifike, specifike.

9 Edhe për këtë që më pyete më herët, nuk e di nëse z.
10 Kadri Veseli e ka kry këtë punë. Që ka mbledh shënime, m'u duk
11 ishte pyetja që ka mbledhur shënime në terren.

12 PY. Përmendët Kadri Veselin në përgjigjen tuaj, po në fakt
13 nuk ishte i përmendur emri i tij në pyetjen time. Pse e thatë
14 ju Kadri Veseli tani?

15 PË. Kadri Veseli ka qenë mbas strukturimit të Ushtrisë
16 Çlirimtare të Kosovës, ka qenë udhëheqës i shërbimit
17 informativ.

18 PY. Lidhur me faktin -- sapo thatë që keni -- nuk keni shumë
19 njohuri për zbulimin-kundërzbulimin. Do shohim një pjesë të
20 dëshmisë suaj.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Që ka tashmë numrin P1870.2 dhe
22 janë faqet 10 dhe -- 12 -- 10 dhe 11.

23 PY. Këtu jeni duke folur për shpërndarjen e oficerëve të
24 FARK-ut nën ombrellën e UÇK-së dhe jeni pyetur:

25 "A ka funksionuar? A shkoi çdo gjë mbarë?"

1 Dhe ju jeni përgjigjur:

2 "Në përgjithësi shkoi mirë. Pati kritika për zonën e
3 Dukagjinit, sepse atje ishte Tahir Zemaj dhe në bazë të
4 informacionit të shërbimit të zbulimit që kishim ne në UÇK,
5 ishim informuar që më përpara ky person ishte marrë me drogë
6 dhe ishte dënuar në të shkuarën për këtë."

7 Pra, ju keni përmendur këtu faktin që ishte një oficer
8 ose një komandant në shërbimin e zbulimit, apo jo?

9 PË. Komandant në shërbimin e zbulimit? Këtë nuk e kuptova?

10 PY. Më falni. E kisha fjalën për Tahir Zemaj. Pra, Tahir
11 Zemaj ishte personi për të cilin po mblidheshin informacione,
12 e sqarova?

13 PË. Po, këtu në rregull është.

14 PY. I nderuar Prokuror, ju e dini, jam mundu me dhënë një
15 sqarim në lidhje me deklaratën që e kam dhënë atëherë.

16 Problemi që e kam pas gjatë dhënies së asaj deklarate kanë
17 qenë pikërisht edhe problemet me përkthimin. Një përkthyes i
18 cili ka ndodh gjatë marrjes time në pyetje ka qenë një
19 shqipfolës, por jo shqiptar. Shpeshherë termat na janë
20 ngatërruar.

21 Po këtu për rastin konkret nuk e di nga kush u ka thonë,
22 nuk e di kush u ka thonë, por më është thënë se nga shërbimet
23 kemi mësu se është një njeri i tillë, për Tahir Zemën. Por
24 kush më ka thënë nuk e di.

25 PY. Përmendët që keni pasur problem me përkthimin në gjuhën

1 shqipe. Dëshmitar, a e dini ju që në fakt TPNJ-ja e ka
2 incizuar këtë intervistë? Është e incizuar intervista juaj.
3 PË. Po.

4 PY. Mbase do të ishte e nevojshme atëherë që të shihnim këtë
5 pjesë konkrete të intervistës suaj.

6 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarit të seancës të
7 vendosë në ekran materialin me numër T000-5325-1-B dhe
8 minutazhi që kemi nevojë të shohim ne është 32:53 deri në
9 34:01.

10 Ne kërkuam që të vendoset edhe transkripti i audios i
11 materialit zanor që ta kemi çdo gjë të qartë. Kështu që, ju
12 lutem, vendosim po ashtu në ekran materialin me numër 1870.2
13 në anglisht edhe në shqip. Më duket se pjesa që na intereson
14 ne është në faqen 10 në të dyja gjuhët.

15 PY. Dëshmitar, një çast sa të dali materiali zanor edhe
16 filmik - më falni - por besoj se ne kemi mundësi që të
17 dëgjojmë çfarë i keni thënë vërtet ju TPNJ-së lidhur me këtë
18 aspekt në 2006.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Sekretari i seancës po ashtu mund
20 të luajë, mund të vendosë edhe videon, ju lutem, 32:53 deri në
21 34:01

22 [Luhet audio-incizimi]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 Z. HALLING: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, ju i keni thënë pra, "shërbimi i zbulimit" për

9 TPNJ-në, këtë keni thënë, apo jo?

10 PË. Po.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të hiqet materiali nga

12 ekrani.

13 PY. Kalojmë tani në fushën e tretë. Këtë po e quaj

14 përkufizimi i termit "kolaboracionist" ose "bashkëpunëtor."

15 Mënyra se si e keni kuptuar ju këtë term, kolaboracionist

16 apo tradhtar, a konsiderohej një person që nuk i qëndronte

17 besnik kauzës së UÇK-së? Mënyra të paktën si e keni kuptuar

18 ju.

19 PË. Unë në atë intervistë e kam dhënë vetëm qëndrimin tim,

20 por jo edhe të Shtabit të Përgjithshëm, për arsye se edhe

21 fjala "kolaboracionist" nuk është as shqip. Vjen prej një

22 fjale të huaj. Kështu që ai ka qenë vetëm një përkufizim i

23 imi. Dhe bashkëpunëtorët nuk besoj që janë vetëm ata të cilët

24 nuk i kanë përgjigj kauzës, por ata të cilët kanë luftuar me

25 armë në dorë kundër kauzës, kundër përpjekjeve të shqiptarëve

1 për liri. Ky ka qenë si përkufizim i imi.

2 PY. Fusha e katërt të cilën dua të trajtoj me ju është një
3 fushë që unë do t'i vendos emrin domosdoshmëri. Besoj se e
4 kemi trajtuar deri në njëfarë shkalle, por ta konfirmojmë edhe
5 një herë; a ishte e domosdoshme që UÇK-ja të kërkonte e të
6 zbulonte bashkëpunëtorët në territorin që kishte nën kontroll?

7 PË. Nuk besoj që ka qenë e domosdoshme. Por realisht në atë
8 kohë Serbia pati instaluar policinë lokale brenda edhe brenda
9 territoreve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Realisht
10 territoret nuk kanë qenë shpeshherë themi si të kontrollume
11 prej UÇK-së, por jo, jo çdo herë dhe nuk ka qenë ideja se s'ka
12 mujt me hy edhe, edhe serbët nëpër ato territore, por ka pas
13 polici nëpër fshatra polici lokale, të cilët kanë qenë të
14 armatosur edhe shpeshherë edhe me uniformë që kanë qenë në
15 shërbim të policisë dhe ushtrisë serbe. Domethënë, në shërbimi
16 të aparatit serb.

17 PY. Dëshmitar, dua të kthehemi në një pjesë tjetër të një
18 deklaratë që keni dhënë më përpara dhe që tashmë është pranuar
19 si pjesë e provave gjyqësore.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe ka marrë numrin 1870.3. Është
21 në faqet 15 dhe 16.

22 PY. Ju thoni kështu:

23 "Një bashkëpunëtor, dhe ne e dimë që këtu bëhet fjalë për
24 një kolaboracionist aktiv me armikun, në përgjithësi këta na
25 kanë bërë më shumë dëm ne se ç'na kanë bërë policët dhe

1 ushtarët serbë", është e padëgjueshme këtu, sepse thotë, "në
2 zona që ishin dhe nën kontrollin e UÇK-së. Dhe me vendim të
3 Shtabit të Përgjithshëm -- dhe me vendim të Shtabit të
4 Përgjithshëm, këta persona konsideroheshin si instrumente të
5 policisë së Millosheviqit dhe të regjimit ushtarak. Edhe hapat
6 që merreshin kundër tyre synonin dhe të përcillnin mesazhin që
7 askush nuk duhet të sillet si këta persona."

8 Pra, Dëshmitar, bashkëpunëtorët ishin veçanërisht të
9 rrezikshëm, apo jo?

10 PË. Po këta kanë mujt me suportu dëmin më të madh sesa vetë
11 serbët, -- sesa vetë ushtria dhe policia, për arsye se
12 policinë dhe ushtrinë kemi mujt me i pas përballë në vijë
13 frontale; ndërsa këta kanë kryer aktivitetin e vet brenda edhe
14 brenda -- të kamufluar edhe brenda pozicioneve të Ushtrisë
15 Çlirimtare të Kosovës.

16 PY. Dëshmitar, ju në përgjigjen tuaj, ju bëni një dallim mes
17 bashkëpunëtorëve, policisë dhe ushtarakëve. Pra,
18 bashkëpunëtorët ishin më shumë sesa thjesht luftëtar, apo jo?

19 PË. Bashkëpunëtorët -- jo më shumë sesa luftëtarë. Policia
20 ushtarake -- policia lokale ishte ajo e cila shkaktonte
21 shkallën e rrezikshmërisë më të madhe sesa të tjerët, për
22 arsye se ata ishin edhe të armatosur.

23 PY. Po ashtu keni thënë në faqen 99 të transkriptit të
24 sotshëm se:

25 "Bashkëpunëtorët nuk janë vetëm ata që nuk i

1 përgjigjeshin kauzës, por edhe ata që kanë luftuar me armë
2 kundër kauzës ...”

3 Dëshmitar, a do të thotë kjo që gjithashtu që edhe
4 personat që nuk i përgjigjeshin kauzës mund të konsideroheshin
5 bashkëpunëtorë?

6 PË. Jo ata personat të cilët s’iu kanë përgjigj kauzës, se me
7 thënë të drejtën në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës jo
8 gjithë qytetarët e Kosovës kanë qenë aktiv në luftë. Dhe ne
9 nuk mund t’i quajmë të gjithë ata qytetarë që s’kanë qenë --
10 të cilët s’iu kanë përgjigj kauzës si bashkëpunëtorë të
11 armikut.

12 PY. Dëshmitar, por para pesë minutash ju thatë këtu që:

13 “Unë besoj se bashkëpunëtorë nuk janë vetëm ata që nuk i
14 përgjigjeshin kauzës, por edhe ata që kanë luftuar me armë
15 kundër kauzës.”

16 A e thatë kështu?

17 PË. Bashkëpunëtorë të cilët ju -- kanë luftu me armë në dorë,
18 po. Por fjala është për ata kolaboracionistë apo ata policë të
19 cilët kanë qenë të instaluar por edhe bashkëpunëtorë të
20 armikut, nëse kanë qenë, ata thjesht nuk janë konë -- për neve
21 nuk kanë qenë të rrezikshëm në qoftë se ata nuk kanë krye
22 veprime kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo nuk kanë
23 dekonspiru pozicionet apo armatimet dhe llojin e armatimit që
24 kemi pas në luftë ne.

25 PY. Mbase këtu mund të na vyente dhe këtu po shkojmë prapë te

1 pjesa e përkufizimeve. Ndoshta do të duhet që të shikojmë se
2 si e keni përkufizuar këtë termë në TPNJ.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe për këtë arsye do kërkoja që
4 Sekretari të mund të na shfaqë edhe një herë videon edhe
5 dokumenti ka këtë referencë për të: T000-5326-1-B. Në minutën
6 e -- në sekondën 00:45 deri në minutën 02:04. Një çast derisa
7 të paraqitet në ekran.

8 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
9 këshillohen]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretari po
11 na thotë që do të ishte më mirë që të kalojmë në seancë
12 private, sepse mund të përmbajë informacion konfidencial ky
13 fragment.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do kalojmë në
16 seancë private në mënyrë të tillë që të mund të transmetojmë
17 versionin në audio.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Halling, statusi i
19 dokumentit është konfidencial. Dhe nga ana tjetër në qoftë se
20 do të dëgjojmë pjesën e regjistrimit të tij i takon që do të
21 nxirret informacioni konfidencial i tij.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull atëherë. Do të kalojmë
23 ashtu siç u kërkua nga Gjykata.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 Le të kalojmë në seancë private.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, z.
2 Halling. Kam një pyetje: A ka ndonjë arsye që pse versioni në
3 audio intervistën me TPNJ-në duhet që të ketë klasifikimin
4 konfidencial nga këndvështrimi juaj?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk është i ndryshëm nga deklarata
6 vet, megjithatë mund të duhet që të zbatohen redaktime të
7 caktuara te regjistrimi, te kaseta. Megjithatë, synimi është
8 që është i njëjti me deklaratën që kemi diskutuar sot këtu.
9 Dhe thamë që informacioni nuk është tërësisht konfidencial.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,
12 atëherë. Le të kalojmë në seancë private dhe pastaj në qoftë
13 se është e nevojshme që të bëjmë redaktime ose të kalojmë në
14 seancë publike, ta bëjmë publike më vonë, mund ta bëjmë këtë
15 gjë.

16 [Seancë private]

17 [Seancë private teksti i fshirë]

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 jemi në seancë publike.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

10 PY. Atëherë për të riorientuar bisedën po ju them dhe një
11 herë, Dëshmitar, që ne folëm për publicitetin, për detyrat,
12 për përkufizimin dhe domosdoshmërinë. Tani dua të flas për
13 fushën e fundit, për vrasjet.

14 A mund të merrnin njësitet e UÇK-së masa për të vrarë
15 spiunë dhe tradhtarë pas një vendimi të marrë nga Shtabi i
16 Përgjithshëm?

17 PË. Duhet me e sqaruar edhe një herë. Nuk ka pas urdhër
18 specifik të veçantë nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së për të
19 vrarë dikën. Por ajo që është publikuar përmes komunikatave
20 publike kështu e kam nxjerrë unë përkufizimin gjatë asaj
21 interviste. Dhe të gjithë ata të cilët janë përballë me
22 persona të armatosur, të cilët në flagrancë ia kanë kthyer
23 pushkën një ushtari të UÇK-së kanë pas urdhër që të rezistojnë
24 dhe deri edhe te vrasja.

25 Ne kemi pas raste të tilla që bashkëluftëtarët tanë janë

1 vrrarë edhe pse kanë kaluar afër shtëpisë së një polici lokal
2 apo kolaboracionisti serb dhe na janë plagosur ushtarët, vetëm
3 se kanë kaluar afër shtëpisë së tina pa pas ndonjë qëllim të
4 caktuar për të. Kemi rastin e ngjashëm me komandantin e
5 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Mujë Krasniqi i cili është
6 plagosur në një rast të tillë. Kemi edhe të arrestuar nga këta
7 njerëz të ushtarëve tanë.

8 PY. Në fillim të përgjigjes tuaj, ju flisni për urdhra
9 konkrete ose specifik. Tani në fakt pyetja nuk është kjo,
10 pyetja ime nuk ishte kjo. Kështu që do t'jua bëj edhe një herë
11 pyetjet, Dëshmitar: Njësitët e UÇK-së a mund të merrnin masa
12 për të vrrarë spiunë apo tradhtarë pas një vendimi të Shtabit
13 të Përgjithshëm?

14 PË. Çdo komandant zone dhe çdo zonë ka pas të drejtë të
15 vendosë mbi këto çështje personalisht. Por nuk ka një urdhër,
16 po them edhe një herë, duke e përsërit edhe një herë, unë të
17 paktën nuk mbaj mend që ka ekzistuar një urdhër i veçantë për
18 një rast të tillë.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të kalojmë në deklaratën tuaj
20 dhe të shohim se çfarë keni thënë lidhur me këtë. Nuk mendoj
21 që versioni në audio është i nevojshëm për këtë gjë, por do i
22 kërkoja Sekretarit që të paraqesë në ekran dokumentin që
23 tashmë është provë gjyqësore me numër P1870.6, faqja 14 në
24 anglisht dhe faqja 15 deri në 16 në versionin shqip.

25 PY. Dëshmitar, të presim një çast ndërkohë që paraqiten

1 deklaratat në ekran dhe shikojmë ekzaktësisht se çfarë keni
2 thënë ju. Të kalojmë më poshtë te versioni në anglisht. Do
3 filloj nga rreshti 11 aty. Pyetja që ju bëhet juve, Dëshmitar,
4 është kjo:

5 "Kush kishte të drejtë që të merrte vendim që një
6 bashkëpunëtor ose kolaboracionist i vlerësuar të mund të
7 vritej."

8 Dhe pastaj vijon më tej.

9 "Domethënë kush ishte personi që ia dha këtë të drejtë.
10 Kush mund ta bënte një gjë të tillë; kush e merrte këtë
11 vendim?"

12 Dhe ju keni thënë që:

13 "Këtë e merrte Shtabi i Përgjithshëm."

14 A është dëshmia juaj kjo, Dëshmitar?

15 PË. Po gjithmonë iu kam referuar, thashë, komunikatave
16 publike që janë dhënë.

17 PY. Këtë e kuptoj. Megjithatë, kjo nuk është pyetja ime,
18 Dëshmitar. A po thoni ju, a është dëshmia juaj, siç është
19 thënë këtu që Shtabi i Përgjithshëm kishte të drejtën që të
20 merrte një vendim që të vritet një bashkëpunëtor ose
21 kolaboracionist?

22 PË. Unë po them edhe një herë se në një intervistë që kam
23 dhënë atëherë dhe që s'kam pas mundësinë me sqaru kështu më --
24 se nuk jam thirr në tribunal për me dëshmu, prapë po them:
25 Shtabi i Përgjithshëm në asnjë moment, unë nuk e di që

1 ekziston kund një dokument që Shtabi i Përgjithshëm ka dhënë
2 urdhra specifike për vrasjen e kolaboracionistëve. Thjesht i
3 është bërë thirrje përmes komunikatave edhe përmes
4 komunikatave publike. Unë kështu e kam konsideru që janë dhënë
5 urdhrat, përmes komunikatave, jo urdhër specifik.

6 Prandaj terminologjitë juridike, domethënë, për mua janë
7 të panjohura dhe s'i kam kushtu shumë rëndësi dhe peshës së
8 përgjegjësisë së një përshkrimi në aspektin juridik se nuk i
9 njoh.

10 PY. Në rregull. Unë nuk po ju kërkoj që ju të jepni
11 përshkrimin në kuptimin juridik. Por ajo çfarë po ju pyes
12 është kjo që kur ju dha mundësia që të korrigjonit deklaratën
13 e dhënë më herët, pra, gjatë seancës përgatitore kur ju kërkuat
14 që të bënit korrigjimet përkatëse, ju nuk keni kërkuar që të
15 bëhet ndonjë sqarim për këtë faqe. Kështu që ajo çfarë është
16 thënë këtu që jua lexova është e saktë, apo jo, Dëshmitar?

17 PË. Po kjo këtu është e saktë. Ne kemi pas atë ditë ato ditë
18 i kemi pas tri dokumente dhe kemi pas edhe atë problemin e
19 përcaktimit të faqeve të cilat i kemi shfletu dhe nuk po e di
20 pse nuk është korrigju kjo. Por thjesht, edhe një herë po e
21 them këtu para jush me përgjegjësi se këtu iu kemi referu
22 thjesht vetëm -- iu kam referu vetëm deklaratave politike që
23 janë dhënë nga Shtabi i Përgjithshëm për këto kategori.

24 PY. Në qoftë se do të kalojmë te një faqe më përpara në
25 versionin në shqip dhe anglisht të deklaratës. Për

1 procesverbal është faqja 13 në anglisht dhe faqja 14 në shqip.

2 Këtu jepet një citim të cilin e pamë edhe më herët. Kur u

3 pyetët:

4 "... në qoftë se komandanti i zonës ishte autorizuar ose
5 kishte të drejtë që të urdhëronte një vrasje?"

6 Ju thoni:

7 "Që sikurse e thashë dhe më përpara, ishte Shtabi i
8 Përgjithshëm që me bazë kolegjiale merrte masa ndëshkuese ndaj
9 bashkëpunëtorëve të armikut."

10 Pra, juve përdornit termin masat ndëshkuese, sepse
11 vrasjet në fakt ishin masa ndëshkuese ndaj bashkëpunëtorëve,
12 apo jo?

13 Z. DIXON: [Përkthim] Është pyetje orientuese.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Në fakt, kështu është thënë. Është
15 në dëshmi.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. Do ta bëj ndryshe pyetjen atëherë. Pse keni përdorur
19 termin "masa ndëshkuese" në këtë pjesë të dëshminë tuaj në
20 përgjigje të pyetjes kur juve ju pyetet në qoftë se Shtabi i
21 Përgjithshëm ishte i përfshirë, mund të merrte vendim lidhur
22 me këtë, apo jo?

23 PË. Po për të njëjtën arsye që e thashë edhe më lart,
24 domethënë, gjithmonë duke iu referuar atyre komunikatave për
25 këto kategori të njëjta të cilat kanë vepruar në -- me armë në

1 dorë kundër ushtarëve tanë. Konteksti i kësaj krejt kjo është.
2 PY. Ne vazhdojmë e dëgjojmë që çfarë keni mësuar juve nga
3 komunikatat. Kështu që do ishte mirë që të shikojmë disa
4 komunikata përpara sesa të vazhdojmë më tej me pyetjet e tjera
5 të miat.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretarit
7 që të paraqesë në ekran provën P273 në anglisht dhe në shqip.
8 Është Komunikata 28.

9 PY. Dëshmitar, kjo është një komunikatë e cilat flet për
10 vendimet e marra nga Shtabi Qendror në dhjetor të vitit 1996
11 dhe janar të vitit 1997. Flet për vrasjen e dy
12 kolaboracionistëve. Dua që të përqendrohemi tek i dyti për
13 momentin, kështu që dua që t'ju lexoj pikërisht pjesën
14 përkatëse:

15 "Vrasje e dytë ishte kundër Maliq Shehollit i cili ishte
16 deputet i PSS-së, bashkëpunëtor i vjetër i UDB-së. Pjesëmarrës
17 në varrimin e antishqiptarit dhe kriminelit serb Milos
18 Nikolic, i cili u ekzekutua nga njësitë tona më 25.10.1996 dhe
19 në ç'rast mbajti edhe fjalimin mortor."

20 Pyetja për ju është kjo, Dëshmitar: Pse ishte relevante
21 në këtë komunikatë që të përmendej leximi i një fjalimi mortor
22 në vdekjen e një bashkëpunëtori ose kolaboracionisti tjetër?

23 PË. Unë këtë nuk muj ta komentoj për arsye se kjo komunikatë
24 për herë të parë po e shoh, për herë të parë -- po di për këtë
25 komunikatë. Kjo është lëshu jashtë Kosovës dhe nuk di edhe

1 arsyet pse janë bë me thënë të drejtën për të. Absolut nuk
2 është diçka që unë e kam pas e njoh si dokument.

3 PY. Këto ngjarje janë nga dhjetori i '96-s dhe 9 janari i
4 1997, të paktën sipas rreshtit të parë të komunikatës. Ju a
5 keni qenë pjesë e Shtabit Qendror në atë kohë, Dëshmitar?

6 PË. Po, unë kam qenë pjesë, por kjo komunikatë për mua është
7 e panjohur edhe raste si rastet janë të panjohura, me thënë të
8 drejtën, se një qytetar i cili ka marrë pjesë në një varrim
9 nuk është dashtë të konsiderohet apo të merren masa ndaj tij
10 çfarë është në këtë komunikatë. Po ky nuk është dokument që
11 unë për vete e njoh.

12 PY. A jeni në dijeni që Shtabi Qendror ndonjëherë ka bërë
13 ndonjë korrigjim ose e ka tërhequr këtë komunikatë ose, pra, e
14 ka korrigjuar ose e ka tërhequr fare këtë komunikatë? Jeni në
15 dijeni të kësaj gjëje, Dëshmitar?

16 PË. Jo, jo.

17 PY. Do shohim një tjetër komunikatë.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit që të
19 kalojmë në provën P274 në shqip dhe në anglisht.

20 PY. Dëshmitar, sa për t'ju orientuar, bëhet fjalë për
21 komunikatën numër 29. Domethënë, është komunikata që vjen
22 menjëherë pas komunikatës që sapo pamë. Edhe kjo komunikatë
23 fillon që:

24 "Me vendimin e Shtabit Qendror të UÇK-së, në zonën
25 operative numër 1, njësitë tona të armatosura kryen një numër

1 të veprimeve çlirimtare.”

2 Pastaj vijohet dhe thuhet që janë vrarë disa persona. Dua
3 që të përqendrohemi te personi i dytë ku thuhet:

4 “Vendimi i dytë çlirimtar u krye më 16 janar 1997 rreth
5 orës 08:00, kundër armikut të përbetuar të popullit shqiptar,
6 Rektorit të Universitetit Serb në Prishtinë, Radivoje Popovic,
7 me ç’rast u plagosën rëndë edhe shoferi zyrtar i tij, Nikola
8 Lalic. Pasojat e veprimeve të tij antishqiptare, në veçanti në
9 ato në fushën e arsimit na janë të njohura të gjithë, janë të
10 njohura për të gjithë ne.”

11 Dikush që ka qenë i përfshirë në aktivitete arsimore
12 kundër shqiptarëve, a mund të konsiderohej si dikush që ishte
13 kundër luftimeve të UÇK-së, Dëshmitar?

14 PË. Jo.

15 PY. Po pse Shtabi Qendror ka lëshuar një komunikatë ose ka
16 marrë një vendim për të ekzekutuar këtë person me këtë lloj
17 arsytimi, se pse është bërë ekzekutimi i tij, pse do jetë
18 marrë një vendim i tillë?

19 PË. Unë nuk e -- thashë edhe këtë komunikatë nuk e di. Në
20 kohën e Shtabit Qendror kryesisht për komunikatat e di që
21 është thënë që shkruhen nga jashtë dhe me to është marrë më
22 tepër edhe për këtë çështje është marrë më tepër Xheladin
23 Gashi dhe Nait Hasani.

24 PY. A jeni në dijeni që Shtabi Qendror e ka tërhequr këtë
25 komunikatë ose në qoftë se Shtabi Qendror ka bërë një

1 korrigjim të kësaj komunikate?

2 PË. S'kam, s'kam njohuri. Për herë të parë po e shoh tash.

3 PY. Faleminderit.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Dokumenti mund të hiqet nga
5 ekрани.

6 PY. Dëshmitar, tani që kemi mbuluar këto fushat të cilët i
7 përshkrova pak më herët, domethënë, publicitetin, detyrat,
8 përkufizimin, domosdoshmërinë dhe vrasjet, dëshiroj t'ju
9 tregoj një dokument.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit për këtë
11 që të paraqesë në ekran dokumentin 0189-1161 deri në 0189-1309
12 në shqip. Ju lutem, shfaqeni këtë në njërën anë të ekranit,
13 ndërkohë që do kërkoj që të paraqitet një përkthim në
14 anglisht, një përkthim i ndryshëm në anglisht për këtë që
15 është dokumenti 0189-1161 deri në 0189-1163

16 PY. Të presim për një çast sa të shfaqen këto dokumente,
17 Dëshmitar.

18 Dëshmitar, këtë jua tregova në fillim për t'ju
19 riorientuar se për çfarë dokumenti bëhet fjalë, domethënë, për
20 çfarë diskutohet -- dokumenti do të diskutojmë bashkë. Siç
21 mund ta lexoni këtu është "Tepër sekret," dhe janë të njëjtat
22 fjalë për LPK-në që e pamë dhe më herët, "Lëvizje Popullore e
23 Kosovës." Më pas thuhet "Liridon Kosova, Studim, Çështjet e
24 Strategjisë dhe të Taktikës së Luftës Atdhetare në Kosovë,
25 Volumi -- ose Vëllimi 1." Vazhdojmë më poshtë deri në fund të

1 faqes ku thuhet, "Prishtinë 1993."

2 Me sa e kam kuptuar unë, Dëshmitar, ju këtë dokument nuk
3 është se e keni parë më herët, apo jo?

4 PË. Jo, jo.

5 PY. Sa për t'ju orientuar pak më tej.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se do të shkojmë te faqja
7 tjetër në të dyja versionet.

8 PY. Do shohim që flet për "Zbulimin dhe kundërzbulimin."

9 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe në qoftë se do të shkojmë më
10 poshtë në faqe. Do i kërkoja Sekretarit të vazhdojmë deri në
11 fund të faqes.

12 PY. Thuhet, "Vëllimi 1, Prishtinë 1993."

13 Z. HALLING: [Përkthim] Tani le të kalojmë te faqja e
14 fundit. Jo faqja e fundit e të gjithë librit, por te faqja e
15 fundit e transkriptit në anglisht që është faqja 3. Edhe një
16 faqe më poshtë në versionin në shqip.

17 PY. Pra, mund të lexoni këtu që është betim. Domethënë, është
18 betimi i LPK-së në këtë faqe.

19 Në këtë studim përfshihet komente të caktuara të cilat
20 unë dëshiroj që t'jua tregoj dhe të shikojmë se si ato
21 krahasohen me dëshminë tuaj. Do filloj pikë së pari me
22 çështjen e publicitetit.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Në versionin në shqip do i kërkoja
24 Sekretarit që të kalojmë te faqja 0189-1286, ndërkohë që në
25 anglisht do kërkoja që të kalojmë te faqja 0189-1286 deri në

1 0189-1287-ET. Faqja në anglisht është e saktë, ndërkohë që sa
2 i takon faqes në anglisht kjo faqe gjendet në një tjetër
3 dokument. Pra, duhet të hiqet dokumenti që ishte në ekran dhe
4 duhet të hapet një dokument i ri. Referenca për këtë për
5 Sekretarinë është 0189-1286 deri në 0189-1287-ET.

6 PY. Z. HALLING: [Mikrofon i çaktivizuar].

7 [Përkthim] Faleminderit. Atëherë të qëndrojmë te kjo
8 faqja. Të fillojmë me këtë. Nuk flasim për publicitetin, por
9 për përkufizimin.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë kalojmë te faqja në fund
11 ku flitet për, ju lutem vazhdoni deri në fund të faqes edhe në
12 shqip edhe në anglisht ku flitet për "Tradhtinë e
13 bashkëpunëtorëve ..."

14 PY. Atëherë ky studim, kundërzbulim i LPK-së e përkufizon
15 kështu tradhtarin:

16 "Me 'tradhtar' ne kuptojmë atë që del kundër atdheut,
17 popullit, lëvizjes etj., që duke u bashkuar me armikun, duke
18 bashkëpunuar me të ose duke bërë punën e tij nxjerr të fshehta
19 të rëndësishme, nuk u qëndron besnik parimeve, ideve e një
20 çështje të madhe, spiunon shokët, atë që shkel betimin."

21 Dëshmitar, a nuk është ky i ngjashëm me përkufizimin e
22 bashkëpunëtorit që ju keni dhënë në 2006 për TPNJ-në?

23 PË. Mund të ketë ndonjë ndërlidhje kështu, por nuk është
24 burimi i kësaj çfarë kam thënë aty nuk do të thotë se është
25 marrë nga ky dokument apo nga në ndonjë dokument i Lëvizjes

1 Popullore. Thjesht ka mujt me rastis, por nuk -- edhe se
2 s'është krejt, krejt i ngjashëm. Ai është konë veç një
3 përkufizim i imi personal dhe unë mendoj se në të gjitha
4 shtetet edhe në të gjitha vendet e botës, në të gjitha vendet
5 e botës mendoj se është një përkufizim i tillë për këto
6 kategori.

7 Kur e kam thënë atëherë nuk e kam referu asnjë dokumenti
8 as të lëvizjes as të Shtabit të Përgjithshëm, por thjesht jam
9 mundur me dhënë një shpjegim mbi bazën e njohurive që kam pas
10 atëherë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po shoh orën.
12 Mbase do të bëjmë një pushim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
14 të bëjmë dhjetë minuta pushim. Mund të dilni nga salla bashkë
15 me Asistenten e sallës.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë
18 minuta pushim.

19 --- Seanca ndërpritet në orën 15.31

20 --- Seanca rifillon në orën 15.41

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
22 sillni dëshmitarin në sallë.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
25 z. Bashota, do vazhdojë Prokuroria me pyetjet e veta.

1 Dëgjojini me vëmendje.

2 Z. Halling, fjala është për ju.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

4 PË. Dëshmitar, do vazhdoj të diskutojmë ende këtë studim.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Por, do i kërkoja Sekretarisë të
6 shihnim faqen 0189-1252 në shqip dhe në anglisht. Në fakt, për
7 këtë anglishtja mund të gjendet në materialin që mban numrin
8 0189-1251 deri në 0189-1256-ET.

9 PY. Dëshmitar, presim sa të dali faqja përkatëse në ekran.

10 Sapo folëm para pushimit, pra, për përkufizimet.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë tek anglisht tek faqja
12 tjetër, ju lutem.

13 PY. Tani mund të flasim për publicitetin. Më intereson
14 paragrafi i dytë në këtë faqe. Çfarë ka thënë Liridon Kosova,
15 ka thënë:

16 "Duhet të bëhet e qartë në kohën e duhur dhe me të gjithë
17 popullin. Kërrkush të mos kujtojë se kriminelët do të
18 shpëtojnë ose do të mbeten të pazbuluar."

19 Tani pyetja që kam për ju është kjo: A nuk është kjo një
20 nga arsyet që keni dhënë dhe ju pse e ka përmendur apo e ka
21 bërë publicitet, i ka theksuar më saktë Shtabi i Përgjithshëm
22 i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kolaboracionistët në
23 komunikatat e veta?

24 PË. I nderuar Prokuror, nuk jam tuj e kontestu materialet që
25 më sillni përpara, po më së pari ky Liridon Kosova as nuk e di

1 kush është, edhe çfarë studimi ka bo, po kjo nuk përputhet
2 asgjë me punën që ka bo Shtabi i Përgjithshëm apo Ushtria
3 Çlirimtare e Kosovës. Mu po më duhet ma tepër është një
4 material i cili i dedikohet aktivistëve të Lëvizjes Popullore
5 sesa Shtabit të Përgjithshëm apo Ushtrisë Çlirimtare të
6 Kosovës.

7 PY. Dëshmitar, që të jemi të qartë, e kuptoj që nuk e keni
8 parë ndonjëherë më përpara këtë. Unë thjesht po ju pyesja që
9 të krahasojmë atë që dini ju dhe atë që shohim këtu. Ju po
10 thoni që kjo nuk korrespondon me luftën e UÇK-së dhe punën e
11 Shtabit të Përgjithshëm. Tani na e shpjegoni pse nuk
12 korrespondon kjo, pse nuk përputhet?

13 PË. Po thjesht ne nuk kemi pasur këto vizione. Nuk janë të
14 ngjajshme, nuk janë dokumente si kanë dalë pej anës tonë këto.
15 Edhe nëse është dalë ndonjë dokument nga Shtabi i Përgjithshëm
16 i UÇK-së, thjesht nuk iu ka referu këtij dokumenti apo këtij
17 studimi. Këto deshta të thom. Mund të jenë të ngjajshme, nuk e
18 përjashtoj mundësinë këtu të fragmenteve të ndryshme, po nuk
19 iu ka referu këtij studimi -- studim, apo dokument apo nuk di
20 sesa -- se si është qujt dhe në cilin vit ka qenë kjo e
21 shkruar.

22 PY. Informacioni që kemi ne është i '93-shit. Ua tregova më
23 herët. Sidoqoftë flasim për ngjashmëritë dhe tani për të folur
24 për ngjashmëritë duhet të shohim pjesën e detyrave.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është në të njëjtën faqe, por

1 në krye të faqes.

2 PY. Sipas këtij studimi thuhet:

3 "Shërbimi informativ mbledh informacione, mbledh lajme
4 nga populli për krerët e reaksionit; si për oficerët,
5 komandantët, përçarësit e lëvizjes, policët, gardianë,
6 Gjykatësit, e persona të tjerë që dorëzohen në njësitet
7 luftarake nacional-çlirimtare. Hetime bëhen edhe për elementë
8 që dyshohet se kanë bashkëpunuar me reaksionin, me qëllim që
9 të zbulohen spiunët dhe tradhtarët e kamufluar."

10 Dëshmitar, këtu përmenden oficerë, komandantë, persona të
11 tjerë të ngjashëm. A nuk është e ngjashme kjo me atë që ka
12 bërë edhe vetë UÇK-ja për Tahir Zemën -- Zemajn?

13 PË. Unë nuk mund ta them këtë. Nuk mund ta them këtë. Po më
14 duket një krahasim jo adekuat. Tahir Zema, më falni për
15 njohuritë e mia ashtu, po Tahir Zema kur është dënu për drogë,
16 më duket se ka qenë edhe publike kështu. Kështu që nuk ka të
17 bëjë shumë me këto krahasime.

18 PY. Nëse shërbimet informative i merrnin informatat për
19 kolaboracionistët nga lajmet që merreshin nga populli, atëherë
20 ku është dallimi mes asaj që thatë ju për Tahir Zemaj me
21 bashkëpunëtorët e tjerë, përkundrejt bashkëpunëtorëve të
22 tjerë?

23 Më falni, pak pyetja nuk ishte e qartë. Do ta bëj edhe
24 një herë pyetjen. Fakti që ky informacion është tashmë publik,
25 çfarë lidhje ka me ngjashmërinë me këtë faqe dhe lidhur me atë

1 që ju dini për Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së?

2 PË. Unë nuk po shoh ndonjë ngjashmëri mes kësaj dhe të
3 Shtabit të Përgjithshëm. Nuk po e shoh.

4 PY. Tahir Zemaj a ka qenë komandant gjatë kohës kur po e
5 verifikonte shërbimi informativ?

6 PË. Komandant? Si komandant se s'po muj me -- pak ma kjartë
7 të lutna. Komandant i UÇK-së apo komandant me grada të ish-
8 Jugosllavisë?

9 PË. A kishte ndonjë pozicion drejtues nga FARK-u drejt UÇK-
10 së? Kur erdhi nga FARK-u te UÇK-ja pati ndonjë pozicion
11 drejtues?

12 PË. E di se ka qenë oficer në shkollë, më duket, të kohës së
13 Jugosllavisë. Po çfarë detyre ka pas në FARK apo nga FARK-u,
14 nuk e di.

15 PY. Po. Edhe këtu tek fjalia përmendeshin dhe oficerët dhe
16 komandant.

17 Fokusohe mi tani tek domosdoshmëria.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Për të folur për këtë temë do
19 kërkoja që të shfaqej në ekran faqja 0189-1260 e studimit.
20 Anglishtja ka numër tjetër, është në një material më vete,
21 pra. Është me numër 1891260 [Sipas përkthimit] deri në
22 101891261-ET [Sipas përkthimit]. Në anglisht është faqja e
23 parë.

24 PY. Poshtë titullit thuhet:

25 "Pas çlirimit të zonave, krahinave, fshatrave e qyteteve,

1 shërbimi informativ i përvishet punës në mënyrë intensive për
2 të kërkuar, zbuluar, ndjekur e asgjësuar kriminelët, spiunët e
3 tradhtarët.”

4 Pyetja që kam unë për ju është: A nuk -- pra, a nuk
5 ndjente domosdoshmëri UÇK-ja, të njëjtën domosdoshmëri UÇK-ja
6 që të gjente kolaboracionistët në territoret që ajo vetë
7 kontrollonte?

8 PË. Unë thashë se ka qenë kompetencë e zonave për t'u
9 interesu për krejt mbarëvajtjen e tyre që kanë pas brenda
10 territorit, dhe kompetencave të zonës, por ata që unë e di,
11 shërbim informativ në '93 e deri domethënë gjatë kohës, gjatë
12 periudhës sa unë kam qenë edhe në Shtabin Qendror, nuk ka pas
13 shërbim informativ brenda mekanizmit tonë. Kujt iu është
14 referu ky dokument ose ky person që po më duket mu është më
15 tepër një emër -- një pseudonim sesa emër i vërtetë, se nuk di
16 nëse ka mbiemrin Kosova në Kosovë, nuk e di. Kënd e ka [E
17 pakuptueshme] nuk e di. Po thashë ma tepër krijohet përshtypja
18 se është një dokument për nevojat e LPK-së, Lëvizjes Popullore
19 të Kosovës.

20 PY. E kuptoj përgjigjen tuaj. Po të jemi të qartë, kur thoni
21 nga ky emër unë mund të them që ky është një pseudonim, pse
22 mendoni ju Liridon Kosova nuk emër por është pseudonim?

23 PË. Po mendoj se s'e kam dëgju si emër, si një njeri që
24 mundet me bo një studim se pa kalu nëpër vesh tonin s'e besoj
25 se kish mujt mjete të informimit ose si studiues që del këtu.

1 Është një emër që s'e kam has mo kurrkund. Kurrkund s'e kam
2 has.

3 PY. Që ta kuptoj unë qartë në shqip. Liridon Kosova në shqip
4 do të thotë, ka ndonjë farë kuptimi që do të thotë "Liri për
5 Kosovën"? Emri Liridon nënkupton fjalën liri?

6 PË. Pse e përkthejmë -- nëse e shqiptojmë drejt është bashkim
7 i dy fjalëve: "Liri", që është liri, dhe "don", domethënë që e
8 don lirinë. Kështu i bjen. Sinkronizim i dy emrave.

9 PY. Faleminderit. E kuptova. Tani të flasim për pjesën e
10 pestë që ishin -- ishte vrasja, apo vrasjet.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë kam nevojë që në ekran të
12 vendoset materiali 0189-0188 në shqip. Edhe anglishtja është
13 brenda të njëjtës gamë, vazhdë dokumentesh me numër 0189-1172-
14 01989-1198-ET.

15 PY. Njësoj, Dëshmitar, do të vendos faqen në ekran dhe do
16 t'ju bëj një pyetje dhe kjo do të jetë e fundit që do të
17 trajtoj për këtë studim.

18 Z. HALLING: [Përkthim] 0188 shqipja. Më saktë, 1188.
19 Faleminderit. Presim dhe një çast për anglishten. Pak -- kemi
20 shkuar shumë lart, duhet të kthehemi disa faqe më përpara, ju
21 lutem. Edhe dy të tjera. Kjo. Është paragrafi në fund të
22 faqes, ju lutem edhe shqipen uleni më poshtë. Është ku thuhet
23 "Roli informativ i njësive klandestine ...".

24 Në këtë studim thuhet kështu, Dëshmitar:

25 "Njësitët klandestine mund të kryejnë aksione të ndryshme

1 si vrasje spiunësh e tradhtarësh, oficerësh dhe policësh. Në
2 vija të përgjithshme, a nuk është pikërisht kjo që ka bërë
3 edhe UÇK-ja duke autorizuar njësitet e UÇK-së për tradhtarët
4 dhe spiunët, mënyra se si duhet të silleshin me ta?

5 PË. Prapë s'po du me paragjyku pse po i referoheni këtij
6 dokumenti, por mund të kenë ngjashmëri, por nuk janë krejt,
7 krejt ndërlidhme. Këtu përshkruan për aktivitetin e LPK-së,
8 realisht nuk po muj me bo një krahasim se nuk iu kemi referu
9 këtij dokumenti kurrë, për asgjë. Nuk po e kontestoj që
10 s'është një dokument i shkruar, nuk po kontestoj që s'e ka
11 përdor LPK-ja në të kalumen, për të cilën unë nuk s'kam
12 informacion, por ndërlidhje me UÇK-në s'po muj me i bo.

13 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky dëshmitar
15 ka lexuar tashmë disa pjesë të këtij studimi, ka përmendur
16 fjalët "ngjashmëri" disa herë. Ky studim është gjetur nga
17 forcat serbet në Kosovë dhe i është dhënë TPNJ-së. LPK-ja siç
18 është vërtetuar tashmë përmes provave është pararendësi apo
19 paraardhësi i UÇK-së, më saktë. Ky material thuhet që është
20 një studim i LPK-së lidhur me taktikat informative dhe këto
21 taktika përmenden shumë edhe janë të ndërlidhura me elementët
22 e ndërmarrjes së përbashkët kriminale në aktakuzën tonë edhe
23 ky dëshmitar po ashtu ka përmendur përpjekjet e UÇK-së kundër
24 -- që janë bërë nga UÇK-ja kundër kolaboracionistëve.

25 Dhe ne kërkojmë që të pranohet sepse mendojmë që është

1 *prima facie*.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Përpara se të flasi z. Dixon thotë
3 që z. Halling tha, është marrë nga forcat serbe në Kosovë. Unë
4 nuk e kam këtë informacion. A mund të na thotë ku është ky
5 informacion?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Mbase ky parashtrim duhet të
7 vijojë pa praninë e dëshmitarit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
9 të duhet të largoheni për pak minuta.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
12 [Përkthim] Duhet të kalojmë në seancë private?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Për pjesën time jo, mund të thuhet
14 në seancë të hapur. Unë mendova se kundërshtimet mbase mund të
15 kenë më shumë hollësi se ç'do ketë parashtrimi im.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për siguri do
17 kalojmë në seancë private.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Për hir të Prokurorit, i dhamë një
5 sy shpejt e shpejt dokumentit dhe dokumenti që citoi ai, nuk
6 citon dokumentin që po përpiqet Prokurori të përfshijë në
7 provë gjyqësore që thotë që ka ardhur nga autoritetet serbe.
8 Dhe kjo e shpjegon arsyen pse nuk kemi ne asnjë informacion.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Po në qoftë se do ta trajtojmë të
11 hënën nuk ka problem.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po z. Dixon
13 dëshiron që ta shohë dokumentin. Bëjmë pesë minuta pushim.

14 --- Seanca ndërpritet në orën 16.06

15 --- Seanca rifillon në orën 16.13

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
17 gjë për të thënë, z. Dixon?

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
19 jemi në seancë private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
5 jemi në seancë publike.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Ne
7 kundërshtojmë pranimin e këtij dokumenti sepse ne parashtrojmë
8 se ky dokument nuk është as afër pragut për provueshmërinë e
9 tij si provë gjyqësore.

10 Kemi pasur mundësi që të konfirmojmë që mesa dimë ne, ky
11 dokument është pjesë e dokumenteve të cilët janë marrë nga
12 forcat serbe në Kosovë. Po, kaq gjë dimë. Nuk dimë çfarë
13 rrethanash është marrë ky dokument ose të gjitha dokumentet e
14 marra dhe nuk është se dimë gjë tjetër edhe për burimin e vetë
15 dokumentit, në kuptimin që kush ka qenë autori, në çfarë
16 rrethanash janë prodhuar dokumentet përkatëse.

17 Ky dëshmitar nuk na ndihmon sa i takon përcaktimit të
18 këtyre faktorëve fare.

19 Pra, e vlerësoj z. Halling që bëri një krahasim edhe i
20 ndau këto krahasime në pesë fusha. Nuk është se kemi
21 kundërshtim lidhur me këtë, ne kemi kundërshtuar vetëm
22 thjeshtë që pjesërisht pyetjet e tij ishin udhëzuese ose
23 orientuese për dëshmitarin, megjithatë, nuk mund të pranohet
24 ky dokument sepse ky dëshmitar nuk pati mundësi që të njohë
25 asgjë nga ky dokument që tregon indicie ose autenticitet ose

1 që vërteton se nga ku e ka prejardhjen ky dokument ose në
2 çfarë rrethanash është përpiluar dokumenti, në mënyrë të tillë
3 që dokumenti të mund të përdorej. Ndërkohë komenti që bëri z.
4 Halling që ka përkueshmëri të lartë midis asaj çfarë thuhet në
5 dokument dhe atë çfarë tha dëshmitari, sipas nesh nuk është e
6 vërtetë, sepse dëshmitari tha që mund të ketë ndonjë
7 ngjashmëri. Ose për shembull fakti që bashkëpunëtorët ose
8 kolaboracionistët mund të jenë të rrezikshëm. Megjithatë, të
9 thuash një gjë të tillë nuk është e mjaftueshme për pranimin e
10 dokumentit por është thjesht një marifet ose një mënyrë për të
11 siguruar provueshmërinë e këtij dokumenti si provë gjyqësore,
12 por kriteret nuk përmbushen.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
14 përcaktojmë një numër provizor për këtë dokument thjesht për
15 të siguruar që e kemi diskutuar atë. Domethënë, do të doja që
16 t'i kërkoja Sekretarit tani që t'i caktojë numër provizor
17 prove dhe pastaj të hënën do marrim vendim në qoftë se do e
18 pranojmë apo jo.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, dua të shtoj
20 përveç asaj që tha kolegu im, Dixon, se përveç faktit që nuk
21 ka ngjashmëri ndërmjet dy dokumenteve po ka pasur një element
22 ku z. Halling krahasoi çështjen e Tahir Zemajt me atë çfarë
23 shkruhet këtu lidhur me komandantët e tjerë.

24 Këtu pretendohet që kjo është shkruar në vitin 1993. Por
25 nuk ka pasur komandant të FARK-ut dhe mendoj që dëshmitari e

1 ka kuptuar që sugjeron që pavarësisht që flitet për '93-shin
2 dhe '93-shin flitet për oficerët jugosllavë. Kështu që ne
3 parashtrojmë që nuk ka ngjashmëri midis rastit të Tahir Zemajt
4 dhe asaj çfarë pretendoi që të shkruhet këtu në '93-shin.

5 Jo vetëm kaq për mbi bazën e asaj çfarë na është nxjerrë
6 ne si material, ne parashtrojmë që nuk ka pasur asnjë person
7 në UÇK ose në LPK që është intervistuar nga ZPS-ja që ka
8 pretenduar që e njeh këtë dokument. Kështu që parashtrimi i
9 këtij dokumenti në këtë mënyrë edhe thjesht argumentimi që ky
10 dokument është i ngjashëm me atë çfarë tha dëshmitari nuk
11 qëndron.

12 Z. HALLING: [Përkthim] A mund të përgjigjemi neve?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. Ne e kemi
14 intervistuar Emrush Xhemajlin, i cili në fakt nuk ka komentuar
15 as për këtë dokument, as për dokumente të tjera, në
16 intervistën e ZPS-së. Megjithatë, ai është autori i historikut
17 të LPK-së që ka marrë numrin e provës -- që ka marrë një numër
18 prove për momentin. Ka dhënë një intervistë sipas rregullës
19 102(3), SPOE00361031 deri në 00361044, dhe në faqen
20 SPOE000361034 [Sipas përkthimit], në poshtëshënimet dhe në
21 faqet pasuese ka thënë që:

22 "Puna teorike dhe strategjia e LPK-së, taktikat e saj për
23 këtë luftë pasqyrohen në vëllimet e punës së tij, pra në katër
24 vëllime."

25 Dhe thotë më tej që:

1 "Prezantimi i secilit prej këtyre vëllimeve ka betimin e
2 luftëtarit të LPK-së që është bërë betimi i luftëtarëve të
3 UÇK-së më pas. Pra, programi ushtarak i LPK-së në vitin '94
4 dhe platforma e bashkimit kombëtar në seksionin politik,
5 unifikimi i të gjithë territoreve shqiptare në ish-Jugosllavi
6 me Shqipërinë është mishëruar në objektiva të UÇK-së dhe është
7 shprehur gjithashtu dhe në betimin e ushtarëve të UÇK-së."

8 Dhe një prej poshtëshënimeve në atë fjali është Liridon
9 Kosova, në katër vëllime, që është një studim ushtarak i LPK-
10 së për aq kohë sa është i pabotuar, por është i arkivuar si
11 material në LPK dhe UÇK.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
13 nxjerrë, por nuk është regjistruar, nuk është pranuar.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Është e saktë. Ne rezervojmë të
15 drejtën për të kërkuar që të shtojmë në listën e provave
16 megjithatë u tha në një rast që janë intervistuar -- nuk ka
17 komente të intervistuarish.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë mendoj që kjo është
19 çorientuese. Dhe ai është intervistuar nga ZPS-ja, por nuk ka
20 thënë që ka njohuri për këtë dokument, gjë të cilën e thashë
21 dhe më herët. ZPS-ja ka intervistuar gjithashtu edhe
22 dëshmitarë të tjerë, disa prej të cilëve kanë thënë që nuk
23 kanë njohur për këtë dokument.

24 Kështu që i qëndroj asaj çfarë thashë më përpara, nuk ka
25 bazë për pranimin e këtij dokumenti.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është çështje
2 intriguese. Thashë do marrim vendim lidhur me këtë të hënë në
3 mëngjes.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kam dhe një çështje tjetër
5 që ka bëjë me dokumentin që citoi z. Halling. Është në faqen
6 5009538 të dokumentit. Shoh që në paragrafin 12 është një
7 kërkesë drejtuar autoriteteve serbe për të dhënë hollësi
8 konkrete.

9 Unë nuk jam e informuar për ndonjë përgjigje që të na
10 jetë bërë me dije ne. Ndoshta kolegu im duhet të na përgjigjet
11 të na thonë në qoftë se kanë marrë ndonjë përgjigje nga
12 autoritetet serbe dhe në qoftë se na e kanë dhënë
13 informacionin ne.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Ja u kam dhënë gjithë
15 informacionin që kam dhe për të cilin kam dijeni sa i takon
16 këtij dokumenti.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
18 Ju lutem, Sekretar, silleni dëshmitarin në sallë.

19 Ju lutem caktoni numrin MFI për të dokumentin.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
21 i caktohet numri MFI P01879.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si jeni me
23 kohën, z. Halling.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Elementet proceduralë po na
25 shkaktjnë vonesa, por pretendoj, ose planifikoj që të

1 përfundojmë seancën e parë të hënën.

2 [Dëshmitari vijon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Bashota,

4 kemi edhe disa minuta të mbetura deri në fund të ditës sot.

5 Besoj që është lajm i mirë për juve që s'kemi dhe shumë kohë

6 për sot. Domethënë, edhe pak minuta. Dhe për këtë kohë do t'i

7 jap fjalën z. Halling.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 PY. Për kohën që na ka mbetur për sot, dua që të kalojmë në

10 një temë tjetër. A ka pasur një mbledhje të Shtabit të

11 Përgjithshëm në Negrovc ku keni marrë pjesë dhe ju rreth vitit

12 -- në vitin 1998? Domethënë, rreth mesit të '98-s më saktë?

13 PË. Nuk mund ta quj mbledhje e Shtabit të Përgjithshëm, por

14 një takim ka ekzistuar.

15 PY. E kuptoj. Kush kanë qenë personat që kanë marrë pjesë në

16 këtë takim?

17 PË. Kanë qenë Jakup Krasniqi, unë, Lahi Brahimi, Rexhep

18 Selimi, Kadri Veseli, kujtoj edhe Hashim Thaçi. Nuk e di a ka

19 qenë [E pakuptueshme]. Tjetër s'ka pas.

20 PY. Të gjithë këto persona të cilët ju përmendët, përfshirë

21 dhe veten tuaj, a kanë qenë të gjithë anëtarë të Shtabit të

22 Përgjithshëm të UÇK-së?

23 PË. Ma vonë, po.

24 PY. Çfarë është diskutuar në këtë takim.

25 PË. Po në atë kohë filloi -- filluan qytetarët që të

1 mobilizoheshin me armë në dorë, duke u kyçur vullnetarisht në
2 luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ishte krijuar
3 përshtypja se në opinion, në disa raste ku lancoheshin
4 propagandat e ndryshme kundër qëllimit dhe përpjekjeve të
5 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe aty është votuar që do të
6 ishte mirë që të dilet me një zë, i cili transmeton qëllimin e
7 luftës së shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe aty
8 është përcaktuar z. Jakup Krasniqi si zëvendës -- si zëdhënës
9 i UÇK-së.

10 PY. Pra, për të qenë të qartë, në qoftë se unë ju kuptova
11 plotësisht drejt, në rastin e takimit në Negroc, në këtë takim
12 është emëruar Jakup Krasniqi zëdhënës i UÇK-së? Këtë thatë?

13 PË. Po. Kujtoj, kujtoj po.

14 PY. A ka pasur emërime të tjera të diskutuara në këtë takim?

15 PË. Janë diskutuar, po ato kanë met vetëm në letër. Nuk kanë
16 mujt me ushtru detyrën, për shkak të rrethanave për arsye se
17 në atë kohë kanë qenë vetëm grupe të vogla [E pakuptueshme]
18 pika, dhe nuk kanë mujt me ushtru këtë, këto funksione.

19 PY. A ju kujtohet se çfarë funksionesh kanë qenë, edhe në
20 qoftë se këto funksione nuk është se janë ushtruar në atë
21 kohë? A ju kujtohen funksionet?

22 PË. Nuk më kujtohen funksionet.

23 PY. Drejtoritë e UÇK-së a janë krijuar përpara takimit të
24 Negrocit, apo pas takimit të Negrocit? Për të qenë i qartë --
25 për të qenë më i qartë e kam fjalën për drejtoritë e Shtabit

1 të Përgjithshëm.

2 PË. Drejtoritë janë krijuar kujtoj ma vonë. Nuk e di saktë,
3 po ma vonë.

4 PY. E jeni i njohur me terminologjinë e NATO-s G1, G2, G3,
5 për emërtimin drejtorive? E keni -- jeni i njohur, keni
6 dëgjuar për këto?

7 PË. Këto mbasi ka ardh Bislum Zyrapi, i cili është marrë
8 kryesisht me strukturimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po
9 kanë -- janë vendos këto G1, G2, G3.

10 PY. Ju folët për emërimet të cilat ishin në letër, që
11 ekzistonin vetëm në letër dhe më pas u bënë reale ose
12 efektive. Mbërritja e Bislum Zyrapit, a ka bërë të mundur
13 efektivitetin e këtyre emërimeve, domethënë që këto emërimet të
14 bëheshin funksionale kur ai ka mbërritur?

15 PË. Me thon të drejtën kur ka ardh Bislum Zyrapi në Kosovë, i
16 ka dhon komplet një dinamikë tjetër strukturimit të Ushtrisë
17 Çlirimtare të Kosovës. Nuk e di nëse i është referu
18 organizimit të NATO-s apo ndonjë organizimi të ndonjë ushtrie
19 tjetër perëndimore, por e di që realisht ai ka arrit që të
20 funksionalizojë, të standartizojë komplet strukturën,
21 domethënë, të -- nga kompania deri tek Shtabi i Përgjithshëm.

22 PY. Bislum Zyrapi a ka mbërritur në Kosovë afër datës së
23 këtij takimi?

24 PË. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet. Më duket -- nuk jam i
25 sigurt.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se
2 do të më lejoni dua të kalojmë tek paragrafi 48 i Shënimit
3 Përgatitor numër 2, që të shohim një mospërputhshmëri të
4 mundshme.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
6 vazhdoni.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është ajo çfarë keni thënë
8 përpara një jave në seancën përgatitore kur keni folur për
9 emërimet në Negroc:

10 "Këto emërimet kanë filluar që të bëhen efektive vetëm pas
11 mbërritjes së oficerëve të duhur, si për shembull, Bislam
12 Zyrapin. Mesa ju kujtohet juve, Bislam Zyrapin ka arritur në
13 Kosovë pak pas këtij takimi."

14 A është e saktë kjo, ose të paktën me aq sa ju kujtohet?
15 A është i saktë ky informacion, Dëshmitar?

16 PË. Edhe unë e thashë, po s'më kujtohet saktë, por besoj që
17 po. Tash kohën nuk po e di saktë. Dhe s'po di përkufizimin
18 "afër" sa me thon. Se po, në ato ditë ka ardh, kujtoj.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e shikoj
20 kohën. Kështu që do propozoja që të vazhdojmë të hënën me këtë
21 temë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
23 Faleminderit.

24 Dëshmitar, kemi përfunduar për sot. Do largohemi sot dhe
25 do vijmë përsëri të hënën në orën 9.00 të mëngjesit. Ju

Dëshmitari: Sokol Bashota (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 152

1 falënderojmë që ishit me ne sot.

2 Faleminderit z. Qerkini që ishit dhe ju i pranishëm sot.

3 Do shihemi përsëri së bashku të hënën.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përfundojmë

6 këtu dhe do fillojmë përsëri në orën 9.00 të mëngjesit të

7 hënën.

8 --- Seanca mbyllet në orën 16.30

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25